# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7160
E hënë, 8 prill 2024
Çmimi 0. 50


## Zelensky: Nevojiten më shumë ushtarë dhe pajisje për ta ndalur ofensivën ruse FAQE 2




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


# PROCESI ZGJEDHOR NË BE DO TË NDIKOJË EDHE NË ANGAZHIMET NË BALLKAN FAQE 4



Sa do të ndikojë kjo në angazhimet në Ballkanin Perëndimor do të varet më së shumti nga shpejtësia me të cilën do të emërohen dhe do t'i marrin funksionet e reja ata që do të caktohen në to. Më 24 prill Parlamenti Evropian do ta mbajë seancën e fundit plenare në këtë përbërje, ndërsa zgjedhjet do të zhvillohen nga 6 deri më 9 qershor. Fundi i punës së Parlamentit Evropian, në prag të zgjedhjeve, shënon edhe nisjen e fazës së tranzicionit institucional në BE

## SERBËT KUNDËR REGJISTRIMIT: A MUND TË KETË PASOJA? F. 5



## PDK-ja KËRKON PËRGJIGJE NGA KURTI, KONJUFCA DHE HAXHIU PËR HUMBJEN DHE GJETJEN E MOSTRAVE TË ASTRIT DEHARIT F. 7




## AKTUALE



### PETER PELLEGRINI I FITON ZGJEDHJET PRESIDENCIALE NË SLLOVAKI F. 2

### POLICIA PARANDALON KONTRABANDËN E 750 PULAVE NGA SERBIA F. 6

### OSMANI KUJTON MASAKRËN E POLACIT DHE TË ABRISË SË POSHTME F. 5

## EKONOMI



### 34 TË RINJ PËRFITOJNË GRANTE PËR T'I HAPUR BIZNESET E TYRE F. 7

### LDK-ja: PËR TRI VJET KJO QEVERI I KA DHËNË 781 TENDERË SEKRETË F. 7

## SPORT



### DRITA MPOSHTI LLAPIN, BALLKANI RIKTHEHET NË POZITËN E PARË F. 12


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755 Fax: +389 44 487 200 Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051 044/367-061 028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

# Zelensky: Nevojiten më shumë ushtarë dhe pajisje për ta ndalur ofensivën ruse

**Kiev, 7 prill** - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, ka thënë se Ukraina duhet ta përgatitë një numër të madh ushtarësh, përfshirë rezervistë, për ta ndalur ofensivën më të fundit të Rusisë në luftën tashmë mbi dyvjeçare.

Gjendja në vijën e frontit është e "vështirë, por e qëndrueshme" tani për tani, tha Zelensky në një intervistë që u transmetua më 6 prill në televizionin ukrainas. Por, Ukraina duhet ta përgatitë një numër të madh të pjesëtarëve për t'i zmbrapsur sulmet ruse, theksoi ai.

Duhet të përgatiten brigada për t'i zëvendësuar ata që janë duke luftuar tani, nënvizoi ai, duke shtuar se kjo nënkupton se një numër i madh i rezervistëve duhet të jenë të gatshëm. "Rezervat nuk përbëhen vetëm nga gra dhe burra të rinj, por nga njerëz me përvojë të cilët kanë kryer stërvitje ushtarake dhe kanë përvojë në luftime", tha Zelensky.

Luftimet janë duke u zhvilluar kryesisht në lindje të Ukrainës në zona të ndryshme, jo vetëm në qytetin e Avdivkës në rajonin e Donjeckut, nga i cili forcat ukrainase u tërhoqën dy muaj më parë, tregoi ai. Dhe, kudo që forcat ruse çajnë përpara, ato zmbrapsën, derisa ushtria ukrainase shënon përparim gjithashtu dhe "bën hapa përpara", sipas tij.

Sipas vlerësimeve nga Shtabi i Përgjithshëm i Ukrainës më 6 prill, 80 luftime u zhvilluan në vijën e frontit më 5 prill, dhe trupat ukrainase i zmbrapsën sulmet ruse në gjashtë zona.



Intervista e Zelenskyt u transmetua pak orë pasi Rusia e sulmoi Harkivin me dronë, duke i vrarë së paku shtatë njerëz dhe duke i plagosur 10 të tjerë, thanë zyrtarët. Qyteti i dytë më i madh i Ukrainës është përballur me sulme shumë të shpeshta në javët e fundit.

Analistët në Institutin Amerikan për Studimin e Luftës sugjeruan më 4 prill se forcat ruse me gjasë janë duke e rritur ritmin e përgjithshëm të operacioneve të ofensivës.

Ndërkohë, Zelensky e përsëriti lutjen e Ukrainës për sistemet kundërajrore Patriot, duke paralajmëruar se Kievi mund të ngelë pa raketa me të cilat i mbron qytetet, qytezat dhe rrjetin energjetik nga sulmet ajrore ruse.

"Nëse ata vazhdojnë ta godasin [Ukrainën] çdo ditë siç janë duke e bërë në muajin e fundit, ne mund të ngelim pa raketa. Partnerët tanë e dinë këtë", shtoi ai.

Ukraina ka rezerva të mjaftueshme për t'ia dalë tani për tani, por po i duhet tashmë të marrë vendime të vështira se ku t'i përdorë ato dhe çfarë të mbrojë me to, sipas Zelenskyt.

Sistemi i sofistikuar kundërajror amerikan është përdorur për t'u mbrojtur nga sulmet ruse me raketa balistike dhe hipersonike.

# Peter Pellegrini i fiton zgjedhjet presidenciale në Sllovaki

**Bratislavë, 7 prill** - Peter Pellegrini, një aleat i ngushtë i kryeministrit populist Robert Fico, e ka mposhtur një kandidat properëndimor për t'u zgjedhur president i ri i Sllovakisë, duke e pasuar Zuzana Captovan.

Pellegrini i fitoi 53 për qind të votave në raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale të shtunën, duke e mposhtur ish-ministrin e Jashtëm, properëndimorin Ivan Korcok, i cili i fitoi rreth 47 për qind të votave.

"Mund t'ju premtoj se do të jem president i të gjithë qytetarëve sllovakë. Zotohem se do të jem gjithmonë në anën e Sllovakisë", tha Pellegrini pas triumfit në zgjedhje.

Pellegrini u bë presidenti i gjashtë i Sllovakisë prej se ajo e fitoi pavarësinë pas rënies së Çekosllovakisë më 1993.



Caputova, një mbështetëse e madhe e shtetit fqinj, Ukrainës, në luftën e saj kundër pushtimit rus, nuk garoi fare për mandatin e dytë për presidente.

Triumfi i Pellegrinit nënkupton se tani kryeministri Fico me aleatë i kanë në dorë Parlamentin, Qeverinë dhe Presidencën e Sllovakisë.

Presidenti i kombit me 5.4 milionë banorë e zgjedh kryeministrin pas zgjedhjeve parlamentare dhe i emëron gjykatësit e Gjykatës Kushtetuese. Presidenti mund ta përdorë edhe veton kundër ligjeve, megjithëse Parlamenti mund ta shfuqizojë veton me një shumicë të thjeshtë, si dhe mund t'i sfidojë ato në Gjykatën Kushtetuese. Ai ka të drejtë edhe t'i falë të dënuarit me burg.

Qeveria, e udhëhequr nga kryeministri, zotëron shumicën e pushtetit ekzekutiv.

Partia Smer e Ficos i fitoi zgjedhjet parlamentare shtatorin e kaluar falë një platforme proruse dhe antiamerikane.

Partia e Pellegrinit, Hlas, e zuri vendin e tretë dhe iu bashkua koalicionit qeverisës me Ficon dhe partinë ultranacionaliste Partia Nacionale e Sllovakisë.

Kritikët druajnë se Sllovakia nën sundimin e Ficos do ta braktisë rrugën properëndimore dhe do ta ndjekë drejtimin e Hungarisë, e cila udhëhiqet nga kryeministri populist Viktor Orban.

Qeveria e re menjëherë e ndali furnizimin me armë për Ukrainën. Mijëra njerëz kanë protestuar vazhdimisht nëpër rrugët e Sllovakisë së fundmi kundër politikave proruse të Ficos, përfshirë kundër planeve për ta ndryshuar Kodin Penal dhe për t'i marrë nën kontroll mediet publike.

Korcok ishte kritik i vendimeve të qeverisë, për të cilat protestuesit druajnë se mund ta minojnë sundimin e ligjit, ndërsa Pellegrini e mbështeti qeverinë e re dhe nuk i vuri në dyshim politikat e saj.

Korcok është ish-ambasador sllovak në Shtetet e Bashkuara dhe në Gjermani, i cili shërbeu edhe si i dërguar i vendit në NATO dhe në Bashkim Evropian.

# Lufta në Gazë hyn në muajin e shtatë

**Gaza, 7 prill** - Ka hyrë në muajin e shtatë lufta mes Izraelit dhe Hamasit - grupit të shpallur terrorist nga ShBA dhe BE - e cila e ka rrënuar Rripin e Gazës, derisa bisedimet për një armëpushim dhe për lirimin e pengjeve pritet të rifillojnë në Kajro.

Teksa lufta më e përgjakshme në historinë e Gazës i mbushi gjashtë muaj, kritikat e vazhdueshme ndërkombëtare janë duke u rritur ndaj Qeverisë së Izraelit për shkak të fushatës së saj ushtarake. Për më tepër, qeveria e kryeministrit Benjamin Netanyahu është duke u përballur edhe me protesta në shtëpi.

Marrëdhëniet e Izraelit me aleatin kryesor, Uashingtonin, janë përkeqësuar, derisa Lindja e Mesme druhet për një përgjigje të mundshme nga aleati i Hamasit, Irani, ndaj një sulmi në Ambasadën iraniane në Siri javën e kaluar, për të cilin u fajësua Izraeli.

Izraeli është përballur me stuhi kritikash për vrasjen e shtatë punëtorëve të grupit të bamirësisë me bazë në Shtetet e Bashkuara, Kuzhina Qendrore Botërore, kur ata po shpërndanin ndihma në Gazë më 1 prill.

Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, ka kërkuar "armëpushim të menjëhershëm" dhe ka paralajmëruar se mbështetja amerikane për Izraelin varet nga mbrojtja e civilëve dhe përmirësimi i kushteve humanitare.

Kryeministri i Britanisë së Madhe, Rishi Sunak, ka kërkuar që "ky konflikt i tmerrshëm të marrë fund".

Lufta në Gazë nisi kur pjesëtarët e grupit radikal palestinez kryen një sulm befasues në jug të Izraelit, duke i vrarë 1 200 civilë dhe duke i rrëmbyer 250 të tjerë.

Izraeli u përgjigj duke kryer sulmet ajrore dhe tokësore që për pasojë kanë pasur vrasjen e më shumë se 33 000 palestinezëve, sipas



autoriteteve lokale në Rripin e Gazës.

Luftimet kanë detyruar mbi 80 për qind të popullsisë së Gazës të zhvendoset dhe qindra mijëra janë buzë urisë, kanë thënë Kombet e Bashkuara dhe agjencitë ndërkombëtare të ndihmës.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# PDK-ja kërkon përgjigje nga Kurti, Konjufca dhe Haxhiu për humbjen dhe gjetjen e mostrave të Astrit Deharit

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 PRILL - Kryetari i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, të dieln në një konferencë për medie u ka parashtruar disa pyetje publike kryeministrit Albin Kurti, kryeparlamentarit Glauk Konjufca dhe ministres Albulena Haxhiu në lidhje me humbjen dhe gjetjen e mostrave të Astrit Deharit.

Tahiri e ka ftuar edhe Prokurorinë Speciale të ndërmarrë veprime të menjëhershme për të vënë para përgjegjësisë secilin zyrtar shtetëror që ka gisht në zhdukjen e mostrave të Astrit Deharit, në kthimin e pjesshëm dhe atë përfundimtar të tyre. "Më 29 mars 2024 opinioni publik u informua për gjetjen e mostrave të Astrit Deharit, vdekja dhe fatkeqësia e të cilit në rrugën e zbardhjes së saj, këto tri vitet e fundit, nën pushtetin e Albin Kurtit, u vështirësia dhe u mjegullua padrejtësisht dhe në mënyrë misterioze. Zhdukja e mostrave, gjetja e pjesshme apo e plotë e tyre për secilin rast është përgjegjësi e institucioneve shtetërore dhe nuk mund të tejkalohet me lehtësi sikur nuk ka ndodhur asgjë", ka thënë Tahiri.

Më tej, ai ka shtuar se të gjithë jemi dëshmitarë se në dhjetor të vitit 2022 u publikua lajmi për zhdukjen e mostrave të Astrit Deharit dhe askush nuk dha përgjegjësi politike që në zyrat shtetërore u zhdukën mostrat e këtij rasti. "Megjithatë përmasat e tragjedisë u zgjeruan e u thelluan, e pyetjet që mbetën pa përgjigje u shtuan kur, nga njëra anë, po në mars të vitit 2023 u gjetën një pjesë e mostrave të Astrit Deharit, pra u gjetën mostrat e lukthit dhe të urinës, por mungonin epruvetat e mostrave të gjakut. Ndërkohë, më 21 nëntor 2023, kur zyrat e IML-së i kaploi zjarri i dytë, 4 muaj më pas u gjetën edhe mostrat e gjakut", ka thënë më tej kryetari i grupit parlamentar të PDK-së.

Sipas Tahirit, jo rastësisht si grup parlamentar i PDK-së, fill pas zjarrit të dytë në IML, zjarrit të nëntorit 2023, inicioi me urgjencë themelimin e komisionit hetimor parlamentar të këtyre ngjarjeve, duke e konsideruar të domosdoshëm një hetim të tillë pikërisht për t'i zbardhur dyshimet e mëdha dhe pyetjet e shumta të cilave ky pushtet nuk dëshiron t'u japë përgjigje. "Jo rastësisht për 4 muaj me radhë ky pushtet është duke e refuzuar themelimin e këtij komisioni. Sot do t'i ngremë disa pyetje ndaj të cilave kryeministri Kurti, kryeparlamentari Konjufca dhe ministrja e Drejtësisë është e domosdoshme t'u japin përgjigje sepse nuk janë thjesht pyetje tonat si parti opozitare, por janë pyetje që i shtron secili qytetar", ka thënë Abelard Tahiri.




Pyetjet të cilat Tahiri i ka parashtruar për udhëheqësit e institucioneve të Kosovës janë këto: "Duke qenë bartës të pushtetit në funksionet më të larta shtetërore, ata duhet të na tregojnë se kush i mori dhe zhduki mostrat e Astrit Deharit dhe a dihet se kush i ktheu? Ku ishin këto mostra dhe për çfarë qëllimi u vodhën nga IML-ja? Zhdukja e këtyre mostrave për një vit e gjysmë a ishte një alibi e pushtetit për të penguar hetimin penal dhe zbardhjen e vdekjes tragjike të Astrit Deharit? Nëse kryetari i Kuvendit dhe kryeministri kanë pasur dijeni për zhdukjen e këtyre mostrave në pranverën e vitit 2022 si ndodhi që ministrja e Drejtësisë të njoftoj qytetarët e Kosovës me gjashtë muaj vonesë, në një konferencë për media në dhjetor të atij viti? A ishte rastësi gjetja e një pjesë të mostrave të Astrit Deharit në mars të vitit 2023 dhe zjarri i parë po ashtu në mars i zyrave të IML-së? A ishte rastësi zjarri i dytë i zyrave të IML-së përmes të cilit ishte shkatërruar sistemi i kamerave dhe për katër ditë me radhë nuk kishte fare vëzhgim të dhomës së dëshmive, pra të dhomës ku mbahen mostrat e rasteve që i trajton ky institucion? A u shfrytëzua ky interval kohor prej katër ditëve kur nuk kishte kamera në IML, që mostrat e raportuara si të gjetura në këtë javë të kthehen ato ditë në dhomën e dëshmive? A është i qëllimshëm raportimi me 4 muaj vonesë i gjetjes së pjesës tjetër të mostrave të Astrit Deharit?", ka pyetur Tahiri.

Prandaj, sipas tij, këto dhe shumë pyetje të tjera kërkojnë dhe meritojnë përgjigje nga ana e kryeministrit Kurti, kryeparlamentarit Konjufca dhe ministres Haxhiu. "Uroj dhe shpresoj që edhe Prokuroria Speciale të ndërmarrë veprimet e menjëhershme për të vënë para përgjegjësisë secilin zyrtar shtetërorë që ka gisht në zhdukjen e mostrave të Astrit Deharit në kthimin e pjesshëm dhe përfundimtar të tyre", ka theksuar kryetari i grupit parlamentar të PDK-së.

# Stradner: Vuçiqi është faktori kryesor i destabilitetit në rajon, liderët perëndimorë duhet ta kuptojnë këtë gjë

PRISHTINË, 7 PRILL - Ivana Stradner, e specializuar në çështjet e sigurisë dhe informacionit dhe një vëzhguese e thellë e gjendjes në Ballkanin Perëndimor, ka ngritur shqetësime serioze lidhur me rolin e presidentit serb Aleksandër Vuçiq në rajon. Stradner në platformën "X" të dielën, ka thënë se disa vende të Bashkimit Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk janë të vetëdijshëm se Vuçiq aktualisht vepron si faktori kryesor i destabilitetit në Ballkan.

Sipas Stradner, inteligjenca serbe ka investuar burime të konsiderueshme për të krijuar një imazh të Vuçiqit si një lider që është i përqendruar vetëm tek përfitimet ekonomike dhe se për këtë arsye, ai duhet të perceptohet si një figurë



stabiliteti.

Kjo strategji, sipas saj, ka për qëllim të bindë figurat kyçe perëndimore për të shikuar përtej ngjarjeve të viteve '90 dhe të fokusohen në potencialin e bashkëpunimit të ardhshëm.

"Inteligjenca e Serbisë ka bërë përpjekje të palodhura për të bindur udhëheqësit në Perëndim se Vuçiqit i interesojnë vetëm financat dhe ekonomia, dhe se kjo përfaqëson një garanci për stabilitet", thekson Stradner. "Kjo taktikë ka për qëllim jo vetëm të krijojë përshtypjen e një Vuçiq të moderuar, por edhe të dobësojë opozitën pro-perëndimore dhe të ushqejë lëvizjet e ekstremit të djathtë".

Stradner vazhdon të theksojë pasigurinë që mbizotëron në Perëndim në lidhje me Serbinë, duke veçuar rolin e kufizuar të Mbretërisë së Bashkuar, që me gjithë kuptimin e situatës, përballet me mungesën e një strategjie të qartë ndaj presidentit serb, si dhe me një mungesë të opozitës së fortë në Serbi.

Stradner shpreh shqetësimin se Ballkani po neglizhohet nga udhëheqësit perëndimorë, ndërsa shumë analistë të huaj tashmë kanë humbur shpresat se perspektiva evropiane e Serbisë do të shtynte Vuçiqin drejt qëndrimeve më demokratike. "Përkundrazi, Serbia, sipas tyre, duket të jetë duke ecur në një ritëm të ndryshëm nga ai i kontinentit evropian, një fakt që vetëm sa rrit shqetësimet për të ardhmen e rajonit", shprehet Stradner.



# Procesi zgjedhor në BE do të ndikojë edhe në angazhimet në Ballkan

Sa do të ndikojë kjo në angazhimet në Ballkanin Perëndimor do të varet më së shumti nga shpejtësia me të cilën do të emërohen dhe do t'i marrin funksionet e reja ata që do të caktohen në to. Më 24 prill Parlamenti Evropian do ta mbajë seancën e fundit plenare në këtë përbërje, ndërsa zgjedhjet do të zhvillohen nga 6 deri më 9 qershor. Fundi i punës së Parlamentit Evropian, në prag të zgjedhjeve, shënon edhe nisjen e fazës së tranzicionit institucional në BE

Prishtinë, 7 prill - Prej të hënës në fushatë do të jetë edhe presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, e cila është kandidate udhëheqëse e Partisë Popullore Evropiane (EPP) për të siguruar edhe një mandat pesëvjeçar në krye të ekzekutivit të BE-së.
Me të në fushatë do të jetë edhe shefi i deritashëm i kabinetit, Bjoern Seriberg si dhe disa nëpunës të Komisionit, të cilët për të evituar konfliktin e interesit, kanë marrë pushim pa pagesë gjatë kohës së fushatës.
Edhe disa komisionarë të tjerë do të jenë në fushatë zgjedhore për partitë e tyre.
Më 24 prill, Parlamenti Evropian do ta mbajë seancën e fundit plenare në këtë përbërje, ndërsa zgjedhjet do të zhvillohen nga 6 deri më 9 qershor.
Fundi i punës së Parlamentit Evropian, në prag të zgjedhjeve, shënon edhe nisjen e fazës së tranzicionit institucional në BE.
Kjo sepse, pas këtyre zgjedhjeve do të formohet edhe Parlamenti i ri, pastaj do të zgjidhet shefi apo shefja e Komisionit Evropian, Përfaqësuesi i Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri dhe, po ashtu, edhe një varg krerësh tjerë institucionalë në BE.
E gjithë kjo, thonë diplomatët në BE, mund të ndikojë edhe në angazhimet e BE-së në Ballkanin Perëndimor.
Ata vlerësojnë kështu pasi për kompletimin e të gjitha pozitave kyçe në institucionet e BE-së do të kalojë një periudhë jo edhe aq e shkurtër, nga pranvera e deri në fund të vitit, varësisht nga gatishmëria e vendeve anëtare për të arritur pajtim rreth ndarjes së posteve.
Formalisht nuk do të ketë ndonjë vakum institucional, për shkak se të gjithë komisionarët aktualë do të jenë në postet e tyre derisa të konfirmohen pasardhësit.
Por, nga aspekti politik, në këtë periudhë BE-ja përmbahet nga ndonjë vendim i rëndësishëm politik financiar apo institucional.
Sa do të ndikojë kjo në angazhimet në Ballkanin Perëndimor do të varet më së shumti nga shpejtësia me të cilën do të emërohen dhe do t'i marrin funksionet e reja ata që do të caktohen në to.
Megjithatë, disa burime diplomatike të Radios Evropa e Lirë në BE, thonë se shumica e vendimeve që kanë të bëjnë me rajonin e Ballkanit Perëndimor tashmë janë miratuar dhe gjërat mund të lëvizin pavarësisht tranzicionit në BE.
Së fundi u arrit pajtueshmëri mes Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian për pakon financiare prej 6 miliardë eurosh për reforma dhe zhvillim ekonomik në Ballkanin Perëndimor.
Ky pajtim u arrit nën presion kohor, pothuajse në minutën e fundit, dhe mund të konfirmohet në seancën e fundit plenare më 23 dhe 24 prill.
Pas marrjes së vendimit, fati i këtij plani nuk do të varet më nga Parlamenti Evropian, pos rolit mbikëqyrës që do ta ketë në të ardhmen.
Edhe negociatat e anëtarësimit, që janë hapur me disa vende të rajonit, mund të avancojnë nëse në Këshill do të ketë konsensus, dhe këtu nuk do të ketë nevojë për rol të Parlamentit Evropian.
Hungaria, e cila e merr kryesimin e radhës së BE-së nga 1 korriku i këtij viti, synon që të hapë disa kapituj të negociatave të anëtarësimit me Serbinë, t'i mbyllë disa kapituj me Malin e zi, të hapë negociata për kapitujt e parë me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut dhe mundësisht edhe t'i nisë negociatat e anëtarësimit me Bosnje e Hercegovinën.
Këto synime para disa javësh i kishte shprehur përfaqësuesi i Qeverisë së Hungarisë në një debat në Parlamentin Evropian.
Hungaria, po ashtu, beson se edhe pagesat e para për disa vende të rajonit nga fondi i rritjes i Ballkanit Perëndimor do të mund të bëhen në pjesën e dytë të këtij viti.
Krejt këto veprime do të varen plotësisht nga vullneti i shteteve anëtare të BE-së.
Një proces i cili mund të ndikohet nga tranzicioni institucional në BE mund të jetë dialogu mes Kosovës dhe Serbisë që, sipas disa diplomatëve të BE-së, edhe ashtu nuk ka shkuar si duhet.
Përfaqësuesi i posaçëm i BE-së për dialog Miroslav Lajčak tashmë është përzgjedhur të jetë ambasador i BE-së në Zvicër nga 1 shtatori i këtij viti.
Pasardhësi i tij në rolin e lehtësuesit të dialogut nuk është caktuar.
Para se të caktohet se kush do ta ketë atë rol, BE-ja duhet të vendosë se si e sheh atë proces dhe rolin e saj në të.
Krejt kjo do të varet edhe kush do të jetë në krye të Shërbimit të Veprimit të Jashtëm të BE-së (EEAS), që është Përfaqësuesi i Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri.
Në rastin ideal, emri i pasardhësit të Josep Borrellit - që e mban këtë pozitë - mund të dihet në verë.
Dhe kjo me kusht që në qershor, vendet anëtare të pajtohen se kush do të jetë president i ardhshëm i Komisionit Evropian, pastaj ai person të marrë mbështetjen e shumicës në Parlamentin Evropian në seancat e para në korrik.
Në atë rast, me propozim të Këshillit Evropian, me pajtim të presidentit të Komisionit, mund të caktohet edhe Përfaqësuesi i Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri.
Ai person ka një rol të dyfishtë, sepse në njërën anë është shef i diplomacisë së përbashkët të BE-së ku përfaqëson vendet anëtare, e në anën tjetër me automatizëm edhe anëtar i kolegjit të komisionarëve evropianë si zëvendëspresident i Komisionit.
Prej kur ka hyrë në fuqi Traktati i Lisbonës, tre persona kanë qenë në këtë pozitë dhe që të tretë kanë luajtur edhe rolin kryesor politik në emër të BE-së në dialogun mes Kosovës dhe Serbisë.
Dialogu kishte nisur në mandatin e Catherine Ashton, kishte vazhduar me Federika Mogherinin dhe tash po zhvillohet nën përkujdesjen e Josep Borrellit.
Ndonëse disa vende të BE-së do të donin që para fundit të gushtit të dihet pasardhësi i Lajčakut, që të sigurohet një vazhdimësi, pa ndonjë vakum në atë pozitë, ka edhe të tillë që mendojnë se ai person nuk duhet të emërohet nga Borrelli, por të pritet pasardhësi i tij në postin e Përfaqësuesit të Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri.
Por shumica pajtohen se dialogu mes Kosovës dhe Serbisë dhe angazhimi në Bosnje e Hercegovinë - si dy sfidat më të mëdha për BE-në në rajon në aspektin e sigurisë - kanë nevojë për një kujdes të vazhdueshëm edhe në kohën e tranzicionit në BE, për shkak të zgjedhjeve evropiane.

# Serbët kundër regjistrimit: A mund të ketë pasoja?




PRISHTINË, 7 PRILL - Banorët e komunave me shumicë serbe në Kosovë - Graçanicës, Mitrovicës së Veriut dhe Leposaviqit - me të cilët ka biseduar ekipi i Radios Evropa e Lirë (REL), kanë pikëpamje të ndryshme lidhur me pjesëmarrjen në regjistrimin e popullsisë që filloi më 5 prill dhe zgjat deri më 17 maj.
Regjistrimi i fundit i popullsisë në Kosovë në vitin 2011 nuk u mbajt në katër komuna në veri - me shumicë serbe - ndërsa serbët në jug të lumit Ibër, me ftesë të Beogradit, kryesisht e bojkotuan procesin.
Mesazh i ngjashëm është shpërndarë edhe kësaj radhe, por jo nga Beogradi, dhe jo për bojkotim të procesit.
Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve në Kosovë, ka konstatuar se serbët nuk do të marrin pjesë në regjistrim.
Kjo parti e ka mbështetjen e Beogradit zyrtar.
Pjesëtarët e kësaj partie janë edhe në krye të institucioneve që financohen nga buxheti i Serbisë.
Për shembull, kryetari i Listës Serbe, Zllatan Ellek, është drejtor i Qendrës Spitalore Klinike në Mitrovicën e Veriut.
Branimir Stojanoviq nga partia Lëvizja Popullore Serbe, ndonëse beson se "nuk është koha" për regjistrimin e popullsisë, thotë se është pothuajse e pamundur të anulohet procesi tani.
Ai thekson se qytetarët duhet të jenë të vetëdijshëm për pasojat me të cilat përballen nëse nuk marrin pjesë në regjistrim.
Alleksandar Arsenijeviq nga Demokracia Serbe beson se shtyrja për një kohë tjetër e regjistrimit të popullsisë është zgjidhja e vetme dhe se ky proces mund të zhvillohet kur të stabilizohet situata socio-politike.
Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, numri i përgjithshëm i banorëve në Kosovë është rreth 1.8 milion, prej të cilëve rreth 25.000 janë serbë.
Megjithatë, sipas vlerësimeve të organizatave joqeveritare serbe në Kosovë, rreth 100.000 pjesëtarë të komunitetit serb jetojnë në Kosovë.
Miodragu nga Leposaviqi, komunë me shumicë serbe në veri të Kosovës, thotë se do t'i përgjigjet regjistrimit, përkundër mesazheve të politikanëve serbë se "nuk është koha për një gjë të tillë". "Koha po kalon, ndërkaq ne po vendnumërojmë. Ne jemi qytetarë të Kosovës dhe mendoj se duhet të regjistrohemi", thotë ai.
Jellena, po ashtu nga Leposaviqi, nuk e di ende nëse do të regjistrohet. "Nuk e di, për momentin nuk kam kurrfarë mendimi për këtë", thotë ajo.
Dragani nga Mitrovica e Veriut thotë se nuk do të marrë pjesë në regjistrimin e popullsisë që filloi më 5 prill.
Si arsye ai thekson se autoritetet e Kosovës duan të tregojnë se sa pak serb jetojnë në Kosovë, për shkak të migrimit të madh të bashkëkombësve të tij në vitet e fundit. "Populli ynë nuk është këtu. Njerëzit kanë shkuar në Serbi, por nuk kanë lajmëruar se e kanë bërë këtë", thotë ai.
Sonja nga Mitrovica e Veriut ka vendosur t'i përgjigjet regjistrimit dhe thotë se ky proces nuk duhet të ndikohet nga politikanët, por që qytetarët të vendosin vetë nëse është në favor të tyre apo jo. "Unë jetoj këtu dhe mendoj se do të qëndroj këtu për të jetuar. Nuk kam opsion tjetër, thjesht, jetoj këtu dhe do të regjistrohem", thekson ajo.
Jasmina konsideron se serbët duhet të regjistrohen. "Le të dihet se sa prej nesh jemi këtu, se kjo është e jona... shumica e njerëzve do të regjistrohen, pse jo? Le të dihet se sa jemi këtu dhe jo gjithmonë me hamendje të përjetshme", shprehet ajo.
Banorët e Graçanicës, me të cilët ka biseduar ekipi i Radios Evropa e Lirë, kanë mendime të ndara.
Derisa Dragani nga kjo komunë me shumicë serbe, afër Prishtinës, thotë se "duhet të regjistrohemi sepse jetojmë këtu", ka nga ata që shprehin skepticizëm.
Millica thotë se ende nuk ka vendosur nëse do t'i përgjigjet regjistrimit, por mendon se duhet të dihet numri i saktë i serbëve që jetojnë në Kosovë. "Duke qenë se nuk dihet sa serbë ka (në Kosovë), sa e kanë braktisur, sa kanë mbetur, cila është struktura sipas moshës, ndoshta duhet marrë pjesë (në regjistrim). Pra, që të dihet se me çfarë disponojmë këtu", thotë ajo.
Por, Vesna konsideron se serbët nuk duhet të regjistrohen, "sepse populli tashmë është larguar". "Çfarë të regjistrojnë? Ata pak të varfër që kanë mbetur? Të gjithë ata që kishin pasuri, janë larguar nga këtu. Nuk e shoh qëllimin (për regjistrim të popullsisë)", thotë ajo.
Përfaqësuesit politikë të serbëve në Kosovë konsiderojnë se aktualisht nuk ka kushte për regjistrim të popullsisë. Sipas tyre, pushteti aktual në Kosovë nuk ka ndjesi ndaj komunitetit serb dhe po përpiqet të zvogëlojë rolin dhe rëndësinë e tyre në shoqëri.
Megjithatë, Branimir Stojanoviq beson se qytetarët nga komuniteti serb duhet të vendosin vetë nëse do të marrin pjesë në regjistrim, duke theksuar se ata duhet të dinë se bojkoti do të ketë pasoja të drejtpërdrejta financiare për pushtetet lokale.
Bazuar në Ligjin për financimin e vetëqeverisjes lokale, ndarja e granteve shtetërore për komunat bazohet në numrin e popullsisë së përgjithshme, numrin e popullsisë pakicë dhe hapësirën gjeografike.
Kjo do të thotë se regjistrimi i komuniteteve pakicë luan rol të rëndësishëm në ndarjen e buxhetit për komunat ku ata jetojnë. "Bojkoti (i regjistrimit) mund të ketë edhe implikime serioze politike për proceset politike, në narracionin e mbështetur nga Kurti dhe shumë njerëz të afërt të tij nga Vetëvendosja, se ka shumë më pak serbë se sa ka në të vërtetë dhe për këtë arsye të drejtat që i kemi të garantuara janë shumë të mëdha", thotë Stojanoviq.

## Osmani kujton masakrën e Polacit dhe të Abrisë së Poshtme

PRISHTINË, 7 PRILL - Presidentja Vjosa Osmani ka kujtuar të dielën masakrën e Polacit dhe të Abrisë së Poshtme. "Polaci dhe Kosova sot kujtojnë prillin e vitit 1999, kur regjimi gjenocidal i Serbisë në një ofensivë njëjavore, vrau 78 martirë të këtij fshati dhe atyre përreth. Sot i kujtojmë dhe përulemi me respekt edhe për 8 dëshmorët e UÇK-së, të cilët ranë në altarin e lirisë. Makineria e regjimit gjenocidal të Serbisë afro dy muaj para kapitullimit të saj, intensifikoi përpjekjet për shfarosjen e popullit shqiptar dhe spastrimin etnik anembanë Kosovës. Më 7 prill makineria vrastare njësoj veproi edhe në Abri të Poshtme, ku u vranë 10 civilë nga Qabiqi. Duke përkujtuar martirët dhe dëshmorët e UÇK-së, ne nderojmë të kaluarën tonë, mbajmë gjallë të vërtetën dhe se ndalim përkushtimin për sjelljen e autorëve para drejtësisë. Qoftë i përhershëm kujtimi për të gjithë të rënët për liri!", ka theksuar Osmani në deklaratën për medie.



## Policia parandalon kontrabandën e 750 pulave nga Serbia



**Mitrovicë, 7 prill** - Policia e Kosovës ka njoftuar se në dy raste të ndara ka parandaluar kontrabandën e 750 pulave nga Serbia. Pas pranimit të informatave relevante dhe angazhimit operativ në terren, Njësitë për Ndërhyrje të Shpejtë (NjNSh-Veri, DPK dhe Perëndim), më 6 prill, në dy raste të ndara kanë ndaluar dy automjete të ngarkuara me mall të dyshuar të kontrabanduar (shpezë/pula). "Rasti 1: Rreth orës 01:00, në fshatin Zhabar-K.K. Mitrovicë, është ndaluar kamioneta Volkswagen LT46, ngjyrë e teget, me targa RKS (02), me rreth 200 (dyqind) pula të kontrabanduara nga territori i Serbisë, me vozitës E.M., mashkull/kosovar, 37-vjeçar, me banim në Mitrovicë, dhe; Rasti 2: Rreth orës 18:30, në fshatin Bube-KK. Zubin Potok, është ndaluar kamioneta Mercedes Benz, ngjyrë e gjelbër, me targa RKS (02), me rreth 550 (pesëqind e pesëdhjetë) pula të kontrabanduar nga territori i Serbisë, me vozitës H.B., mashkull/kosovar, 50-vjeçar, me banim në Mitrovicë. Me autorizim të Prokurorit të Shtetit janë iniciuar dy raste 'Kontrabandim me mallra', kamionetat dhe malli i kontrabanduar janë dërguar në terminalin doganor në Mitrovicë për procedura të mëtejme nga autoritetet kompetente (Dogana e Kosovës dhe Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës)", ka njoftuar Policia e Kosovës.

# Lista Serbe thotë se s'do të marrë pjesë në votim për shkarkimin e kryetarëve në veri

**Mitrovicë e Veriut, 7 prill** - Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve të Kosovës, ka njoftuar të dielën se nuk do të marrë pjesë në një votim për shkarkimin e kryetarëve shqiptarë të katër komunave me shumicë serbe në veri të Kosovës, i cili është caktuar për 21 prill. "Qëndrimi i Listës Serbe është të mos marrë pjesë në referendumin e thirrur nga Albin Kurti [kryeministri i Kosovës], sepse ai bëri gjithçka që ai të dështojë", tha kryetari i Listës Serbe, Zllatan Elek, të dielën në një konferencë për medie në Mitrovicën e Veriut.



Ai tha se janë vendosur "procedura të parealizueshme" për votimin e 21 prillit dhe se listat e votuesve "nuk e pasqyrojnë gjendjen reale në terren" dhe se numri i shqiptarëve në listat e votuesve "është rritur". "Për dy muaj në të gjitha komunat numri i votuesve është rritur në mënyrë disproporcionale, për 433 për qind", tha kryetari i Listës Serbe.

Elek nuk dha asnjë dëshmi për pretendimet e tij për rritjen e normë të listave të votuese.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Kosovës vendosi që votimi të mbahet më 21, pasi i verifikoi nënshkrimet e qytetarëve në peticionet për shkarkimin e kryetarëve të komunave me shumicë serbe në veri të Kosovës - Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok.

Nënshkrimet u mblodhën në mesin e muajit janar në përputhje me një udhëzim administrativ të nxjerrë nga Qeveria e Kosovës, me qëllim që t'i hapte rrugën shpalljes së zgjedhjeve të parakohshme në komunat e veriut për shkak se popullata vendase serbe nuk ka pranuar kryetarët shqiptarë.

Sipas udhëzimit, të miratuar shtatorin e vitit të kaluar, që ky votim të jetë i suksesshëm, duhet 50 për qind, plus një votë e qytetarëve me të drejtë vote. Pas kësaj, rezultati i dërgohet presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, e cila ka afat ligjor prej 30 deri në 45 ditë për ta shpallur mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme.

Kryetarët shqiptarë u zgjodhën në prill të vitit 2023 në zgjedhjet të cilat u bojkotuan nga serbët në shenjë pakënaqësie me politikat e Qeverisë së Kosovës.

Nisja e detyrës së tyre nxiti tensione në fund të majit të vitit të kaluar të cilat kulmuan në Zveçan, pasi protestuesit serbë u përleshën me pjesëtarët e misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR.

Bashkësia ndërkombëtare kishte kërkuar uljen e tensioneve dhe shpalljen e zgjedhjeve të reja në katër komunat në veri të Kosovës.

Peticioni ishte nënshkruar edhe nga përfaqësuesit e Listës Serbe, parti që bojkotoi zgjedhjet e prillit të vitit 2023.

Kjo parti kishte iniciuar largimin e serbëve nga institucionet e Kosovës në nëntor të vitit 2022 dhe më pas kishte bërë thirrje për bojkotimin e zgjedhjeve të prillit të vitit të kaluar. Mirëpo, në mesin e tetorit të vitit 2023, ajo deklaroi se ishte e gatshme të merrte pjesë në zgjedhjet në komunat në veri pa vendosur asnjë kusht për pjesëmarrje në zgjedhje, siç kishte bërë më herët.

## Bogujevci shtroi iftar për përfaqësueset e BIK-ut, gratë deputete, ministre të qeverisë dhe zyrtare të administratës së Kuvendit



**Prishtinë, 7 prill** - Nënkryetarja e Kuvendit të Kosovës, Saranda Bogujevci, ka shtruar iftar për përfaqësuese e Departamentit të Gruas të Bashkësisë Islame të Kosovës, të drejtuar nga koordinatorja Vaxhide Podvorica-Bunjaku, deputetet gra, ministre të Qeverisë së Kosovës dhe zyrtare të Administratës së Kuvendit.

Duke uruar muajin e shenjtë të Ramazanit, nënkryetarja Bogujevci theksoi rolin e rëndësishëm të gruas jo vetëm në familje, por edhe në jetën institucionale. Ajo shtoi se muaji i shenjtë i Ramazanit nuk e ka vetëm rëndësinë e agjërimit, por edhe të familjes dhe bashkimit. "Rëndësia e këtij muaji është reflektim drejt solidaritetit, mirëqenies, qoftë fizike, qoftë mendore dhe, në të njëjtën kohë, kujdesit ndaj njëri-tjetrit", tha nënkryetarja Bogujevci.

Ajo u shpreh e lumtur që i është dhënë mundësia të jetë në mesin e grave, duke shpresuar që një organizim i tillë të bëhet tradicional.

Një fjalë rasti mbajti edhe Vaxhide Podvorica-Bunjaku, koordinatore në Departamentin e Gruas në BIK, e cila falënderoi nënkryetaren Bogujevci për ftesën e iftarit. Gjatë fjalës së saj, Podvorica-Bunjaku shpalosi rolin dhe punën e grave në Bashkësinë Islame të Kosovës.

## LDK-ja: Për tri vjet kjo qeveri i ka dhënë 781 tenderë sekretë

**Prishtinë, 7 prill** - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka thënë se lufta kundër korrupsionit është propagandë. Sipas LDK-së, për vetëm tre vjet kjo qeveri i ka dhënë plot 781 tenderë sekretë; plot 209 milionë euro të dhëna në formë sekrete. "I bie që çdo ditë në këtë qeveri është nënshkruar në 4 sy 1 tender sekret. Pra, një tender sekret për çdo ditë. Praktika e tenderëve sekretë është rritur nga viti në vit; 30 milionë vitin e parë, 70 milionë vitin e dytë, plot 109 milionë euro në vitin e tretë", është thënë në njoftimin e LDK-së.




# Kurti: Përkushtimi i qeverisë ndaj ndërmarrësve dhe industrisë ka qenë thelbësor gjatë qeverisjes sonë

**Prishtinë, 7 prill** - Kryeministri Albin Kurti ka theksuar se përkushtimi i qeverisë ndaj ndërmarrësve në vend dhe industrisë ka qenë thelbësor përgjatë gjithë qeverisjes së LV-së. "U dhamë mbështetje në rritjen e konkurrencës 499 bizneseve me potencial eksporti, përmes skemave të granteve për avancim të teknologjisë, standardizim e certifikim, trajnim dhe digjitalizim, në vlerë totale të granteve prej 15.2 milionë eurosh. Përmes mbështetjes prej 33 milionë eurosh për Fondin Kosovar për Grananci Kreditore, janë garantuar mbi 1 000 kredi për afër 1 000 biznese në vlerën prej 67 milionë eurosh. Përfituesit kryesorë kanë qenë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në sektorët industrialë me potencial eksporti. Gjithashtu, në kuadër të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, masës 2.1 për subvencionimin e kredive investuese, kemi mbështetur me 12.4 milionë euro gjithsej 450 biznese. Bizneset i kemi përkrahur edhe në ndërkombëtarizimin dhe promovimin e produkteve dhe shërbimeve të tyre. Me mbështetjen tonë 250 biznese kanë marrë pjesë në 41 panaire ndërkombëtare", ka shkruar Kurti në "Facebook".

Për ta lehtësuar barrën administrative dhe financiare të bizneseve, Kurti ka theksuar se kanë digjitalizuar shërbime dhe thjeshtëzuar procedura si dhe kanë ulur dukshëm tarifat për leje dhe licenca. "Është krijuar pika e vetme e kontaktit për shërbime në platformën e-Kosova, ndërkohë që kemi digjitalizuar shërbime në sektorin e auditimit. Kohëzgjatja për lejet dhe licencat për produkte të naftës dhe duhanit është zgjatur nga 2 në 6 vjet.



Tarifat për tregti me produkte të naftës janë ulur nga 500 deri në 5 000 sa ishin më parë, në 50 euro për të gjitha llojet e lejeve. Njësoj kemi ulur edhe tarifat për tregti me produkte të duhanit. Nga 3 000 deri në 20 000 euro sa ishin, në 55 euro për të gjitha llojet", ka deklaruar Kurti. Sipas tij, raporti i Progresit për Vendin për vitin 2023, në veçanti vlerësoi si progres të dukshëm plotësimin e kornizës legjislative, të hartuara nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Po ashtu, ka theksuar se ky raport vuri në pah përmirësimin e dukshëm të mbikëqyrjes së tregut. "Numri i inspektimeve nga Inspektorati Qendror i Tregut është për 63 % më i lartë se në vitin 2019 - si dhe rritjen e përformancës së Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë", ka thënë Kurti.

# Ibrahimi kërkon nga Murati bartjen e të hyrave vetjake të komunave



**Prishtinë, 7 prill** - Drejtori ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Sazan Ibrahimi, ka kërkuar nga ministri i Financave, Hekuran Murati, që t'u barten komunave paratë që u takojnë në kuadër të të hyrave vetjake. "Bazuar edhe në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike (LMFPP), të hyrat vetjake të komunave barten në vitin fiskal duke ruajtur strukturën e shpenzimit. Këtë e kanë bërë komunat gjatë hartimit dhe miratimit të buxheteve komunale për vitin 2024", ka thënë Ibrahimi. Si pasojë e vonesave të tilla nga MFTP komunat do të kenë pasoja si në mundësinë për mosrealizimin e shumë projekteve kapitale nëpër komuna bazuar në nevojat e qytetarëve, po ashtu shkaktohen vonesa në pagesa ndaj operatorëve ekonomikë dhe që këto vonesa mund t'i dërgojnë komunat te përmbaruesi. "Që mjetet të barten për projektet e përfunduara (pra të barten në të njëjtin kod buxhetor) dhe që komunat do të kenë nevojë për rialokime të reja, e që si pasojë e këtyre rialokimve do të ketë zvarritje të tepërta në realizimin e projekteve sepse, përveç burokracive të tepërta ligjore, edhe proceset e tenderimit po marrin shumë kohë. Kjo nuk ka ndodhur më herët. Dëmtohen komunat në raportet e auditimit. Krijohen vonesa të pakuptimta në bartjen e bilanceve të pashpenzuara si dhe bëhet censurim i shfrytëzimit të mjeteve vetjake bazuar në LMFPP. Pra, ministër Murati, bartjani komunave mjetet financiere sepse këto mjete janë të komunave dhe çdo vonesë do të shkaktojë probleme në investime kapitale e të cilat investime ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës së qytetarit", ka thënë Ibrahimi.

## 34 të rinj përfitojnë grante për t'i hapur bizneset e tyre

**Prishtinë, 7 prill** - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, së bashku me drejtorin e GIZ-it në Kosovë, David Oberhuber dhe drejtoreshën e Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, Jehona Rexha, takuan 34 përfituesit nga masa e vetëpunësimit.

Në kuadër të kësaj mase, të rinjtë fillimisht janë trajnuar për ndërmarrësi dhe zhvillim të planeve të biznesit, e ku në mesin e mbi 100 të trajnuarve, 34 sosh janë përzgjedhur për të qenë përfitues të granteve individuale me vlerë deri në 3 000 euro.

Ideatorët e planeve të përzgjedhura u pritën nga ministri Murati i cili ritheksoi mbështetjen ofruar të rinjve në punësim dhe vetëpunësim. Ndër të tjera, Murati shprehi se "si MFPT po fuqizojmë të rinjtë t'i materializojnë idetë e tyre duke hapur biznese ku, përveç mbështetjes financiare, ofrojmë edhe mentorim përgjatë muajve të parë të operimit të biznesit".

Nga ana e tij, drejtori Oberhuber theksoi bashkëpunimin ndërmjet GIZ dhe APRK në zbatimin e disa projekteve të përbashkëta, ku synimi është zhvillimi i masave aktive të tregut të suksesshëm që kanë potencial të shndërrohen në skema të përhershme.



Drejtoresha Rexha theksoi rëndësinë e masës së vetëpunësimit si shtysë për nxitjen e ndërmarrësve në mesin e të rinjve, duke thënë se kjo masë tashmë mundëson kalimin e 34 punëkërkuesve në punëdhënës.

Pjesa e dytë e takimit u fokusua në një diskutim të hapur ndërmjet ministrit Murati dhe të rinjve përfitues, ku këta të fundit patën mundësi t'i shpalosin idetë e tyre, por edhe të marrin këshilla në rrugën e tyre drejt ndërmarrësisë.



# PJESË E FJALIMIT TË ALI AHMETIT NË KRYETUBIMIN E MADH KOMBËTAR NË GOSTIVAR MË 30 MARS 2024

UDHËHEQËSIT POLITIK, NJERËZIT GJURMËMËDHENJ TË KËTIJ VENDI

"…Duke përkujtuar Rafi Halilin e madh, i cili nuk u mposht për 15 vite me radhë!

Duke përkujtuar të pamposhturin Mehmet Gega, i cili asnjëherë nuk e uli kurrizin përpara pushtueseve!

Duke vazhduar me historinë ma të re, këtu në vendin tonë, Arbën Xhaferin, Imer Imerin, Abdurrahman Alitin e Muharrem Nexhipin!

Duke përkujtuar, të gjithë gjeneratën që në vazhdimesi punoi pa u ndalur,si në vend edhe në mergim, Fazli Velinë e Gëzim Oztrenin, si drejtues në dy luftra, dhe duke përfunduar me Nevzat Halilin, që nuk duhet harruar, fillim e një lëvizje të mbarë për shqiptarët në Republikën e Maqedonisë Veriut…!

E pergatiti,
*Ismet SYLEJMANI,*

Prishtinë, 7 Prill 2024



# Paragjykimi i identitetit kombëtar

Nga: Zahira JASER / *The Financial Times (titulli origjinal: Coming out as Palestinian)*
Përkthimi: Agron SHALA / *Telegrafi.com*

Shumë herë në jetën time, kam harruar se jam palestineze. Kur njerëzit pyesnin: "Nga vjen emri yt?", shpejt përgjigjesha: "Është arab". Ka qenë gjë e ndërlikuar të jesh grua e re, me theks të huaj, në katin për tregti të një banke të investimeve amerikane në Londër. Nuk duhet të ngatërrosh njerëzit më shumë.

Por, gjatë bombardimeve të Gazës në vitin 2021, diçka ndryshoi. Mes heshtjes së opinionit publik, ishte e tepërt vuajtja që ndjeva duke parë njerëzit e mi të vrarë. Nisa të flas për identitetin tim. Një ditë takova disa shoqe për kafe. Njëra prej tyre më pyeti se pse dukesha kaq e trishtuar. "Sepse jam palestineze", thashë. Kohët e fundit një tjetër më tha se i kujtohej se ka menduar se "kjo është ajo që ndodh kur ti publikisht shfaqesh si palestineze". Jam palestineze dhe italiane, me ten të bardhë, sy të kaltër dhe theks të lehtë italian. Nuk jam "qartësisht" palestineze – shumë njerëz mendojnë se jam evropiane kur më takojnë – kështu që ndihej si shfaqje publike. Mos më keqkuptoni, të qenit palestineze është një nga nderet më të mëdha të jetës sime. Por, mund të ndihet si identitet shumë i stigmatizuar, i përforcuar nga supozimet raciste. Ky është realiteti i jetuar nga shumë palestinezë.

Akademikët Yasmeen Abu-Laban, i cili është palestinez, dhe Abigail Bakan e cila është hebraike – e të cilët jetojnë në Kanada – argumentojnë se tri forma i merr diskriminimi i drejtuar ndaj palestinezëve. Së pari – mohimi i historisë palestineze apo edhe ekzistenca e popullit palestinez. Së dyti – mohimi i pabarazisë që përjetojnë nën regjimin e Izraelit. Dhe, së fundi – supozimi i përgjithshëm se palestinezët dhe aleatët e tyre mbështesin terrorizmin dhe antisemitizmin. I kam përjetuar të tri këto.

Në të kaluarën, thjesht i harroja këto episode. Por, dhuna aktuale kundër palestinezëve në Gazë, e barabartë me gjenocidin, po më dëmton aq shumë saqë nuk mund të funksionoj më siç duhet. (Shënim i redaktorit të FT-së: Izraeli mohon se po ndodh gjenocidi.) Në pesë muajt e fundit nuk kam qenë në gjendje të mendoj qartë. I filloj detyrat dhe harroj t'i përfundojato. Gjithmonë jam e lodhur, gjithmonë e trishtuar. Natyrisht, si punëtore e madhe dhe e zellshme, e kam humbur interesimin për punë dhe për të folur me njerëz e tjerë.

Qëkur fillova ta shkruaj këtë ese, disa muaj më parë, niveli i pamjaftueshëm i ndihmës humanitare që arrin në Gaza, qindra-mijëra civilë i ka çuar në vdekjen nga uria. Një raport nga Shkolla e Higjienës dhe Mjekësisë Tropikale në Londër dhe nga Universiteti Xhon Hopkins, parashikon më shumë se 85 mijë vdekje deri në gusht – nëse asgjë nuk ndryshon. Më mirë se kurrë tani e kuptoj frikën për të cilën kanë folur shumë nga miqtë e mi hebrenj: frikën e fshirjes. Kjo tani është edhe frika e palestinezëve. Dhe, është frikë që lulëzon në heshtje.

Linda në Itali në vitet 1970. Nëna ime, feministe italiane, më mësoi të jem e sigurt dhe këmbëngulëse. Babai im palestinez ma rrënjosi ndjesinë e rëndësisë së dinjitetit njerëzor, të respektimit të të gjithëve, pavarësisht nga bindjet e tyre fetare apo nga postet që kanë. Si jerusalemian i vërtetë, e dinte se njerëzit e të gjitha besimeve mund të jetonin së bashku në paqe. E kishte përjetuar këtë duke u rritur në Qytetin e Vjetër. "Gjithmonë mbaje kokën lart", më thoshte. Kur isha fëmijë, mendoja se kjo ishte veçse pjesë e edukimi të mirë moral. Më vonë kuptova se prindërit e mi po më përgatisnin për diskriminimin me të cilin një grua e re palestineze kishte mundësi të përballej.

Më kujtohet kur për herë të parë e ndjeva stigmën e të qenit palestineze, si adoleshente, duke u shoqëruar me një grup të miqve. Ishte fillimi i viteve 1990 dhe unë mbase thash se babai im ishte palestinez. Një nga fëmijët e "famshëm" i shfaqi shpejt njohuritë e tij për çështjet ndërkombëtare, duke më quajtur terroriste. Të gjithë qeshën. Jo, thashë, babai im erdhi në Itali për të studiuar mjekësinë. Nuk ishte terrorist. Por, në javët dhe muajt që pasuan, shakaja u normalizua mes nxënësve të tjerë dhe recitohej nga kushdo që donte të minonte besimin tim.

Në vitin e parë të universitetit në Itali, u përballa me një student të përfshirë në politikë, i cili ishte këshilltar i pushtetit vendor. "Palestinezët nuk ekzistojnë", më tha. "Janë shpikje për të parandaluar hebrenjtë që të marrin tokën e vet". Kjo ishte hera e parë kur ekzistenca ime e thjeshtë përcaktohej si kërcënim për njerëzit e tjerë. Më zuri në befasi. Mendimi im i parë ishte fustani siti (i gjyshes) i zbukuruar me tatrizin palestinez, me qëndisjen tonë tradicionale, të cilin e doja qëkur isha fëmijë. Mendova për mënyrën e saj të mbajtjes së mbulesës, siç bënin gratë e krishtera. Mendova për këngët palestineze që njihja, për ushqimin, erën e zatarit palestinez. Si mund të shpiken gjithë këto për të ndaluar hebrenjtë që të marrin tokën e vet? Më tmerroi ideja se dikush mund të mendojë kështu. Kjo ende ndodh.

Teksa rritesha, nisa të kuptoj se për çfarë përpiqeshin të më paralajmëronin prindërit e mi. Për diplomën time universitare, disertacioni im në ekonominë e zhvillimit u fokusua në distriktin industrial të këpucarëve të Hebronit në Bregun Perëndimor. Në verën e vitit 1996, udhëtova atje për të intervistuar sipërmarrësit dhe për të studiuar zinxhirët e furnizimit dhe ekosistemet e biznesit. Në aeroportin ku do të merrja fluturimin tim për në Evropë, për katër orë më mbajtën dhe më morën në pyetje forcat



izraelite të sigurisë. Në fund më çuan në një furgon të veçantë, për të hipur në fluturim, ku ballafaqova shikimin poshtërues të pasagjerëve të dyshimtë të cilët u vonuan për më shumë se një orë. Bagazhi im u konfiskua dhe m'u kthye disa ditë më vonë. Çfarë e nxiti këtë trajtim, si dhe episodet e mëvonshme, nëse jo identiteti im palestinez?

Pasi punova për disa vjet në bankë, u trajnova si studiuese. Në vitin 2018, teksa isha duke bërë doktoratën time, mora pjesë në një konferencë lidershipi. Pas prezantimit të kërkimit tim, m'u afrua një koleg i sjellshëm hebre-amerikan, i cili më tha se atje ishin disa studiues izraelitë të cilët ndiheshin të kërcënuar nga prania ime. Refuzonin të merrnin pjesë në çdo seancë ku unë isha e përfshirë. Erdhi si befasi. Ndoshta isha naive, por kërkimi im – për lidershipin e menaxherëve në kompanitë e mëdha – nuk mund të quhej kërcënues as politik.

Në darkë, në atë mbrëmje, u ula pranë një komandanti ushtarak izraelit, i cili bënte doktoratën në lidership. Ishte qëllimmirë, por e supozoi një lloj simetrie në marrëdhënien të cilën unë nuk e ndjeja. Nuk e kuptoi ndjenjën time të brishtësisë dhe frikësimit. Me qëllim fola, duke më rrahur zemra, për brishtësinë e të qenit palestineze. Gjithçka që mbaj mend tani është skica e bisedës, por ajo që më mbeti në mendje është konfuzioni. Ai më tregonte për stërvitjen që marrin ushtarët, se si të vendosnin kur duhet të tërheqin këmbëzën. Për mua, gjithçka dukej si zbutje e goditjes së pushtimit të armatosur i cili mbyste gjithnjë e më shumë aftësitë e familjes sime në Bregun Perëndimor – për të punuar, për të udhëtuar lirshëm dhe për të bërë jetë normale.

Me kalimin e kohës, nisa të kuptoj më mirë dhimbjen e brezave nga të qenit palestinez. Përse babai im, i cili u transferua nga Jerusalemi për në Itali për të studiuar mjekësinë më 1964, kurrë nuk diplomoi. Ky gjithmonë mbeti mister për mua, pasi ai i kaloi të gjitha modulet dhe madje e shkroi disertacionin e vet. Tani e kuptoi se ai nuk mund të funksiononte siç duhet. Edhe në një distancë gjeografike nga Gaza, njohja e asaj që po ndodh atje vendos një barrë të madhe në burimet emocionale dhe kognitive të palestinezëve në diasporë. Mund të paramendoj se si është ndier babai im në vitin 1967, kur Izraeli ndaloi kthimin e atyre që jetonin jashtë vendit. U mbyll jashtë. Ka mundur të jetë mjek i madh. Në vend të kësaj, u bë biznesmen jo edhe aq i mirë.

E kuptova se pse, në dëshpërimin e vet, babai nuk ma mësoi arabishten. Mendoj se donte të më mbronte. Më mirë të jesh italian, të flasësh italisht, të jetosh në Evropë. Përpiqej të më mbronte nga ndjenja e fundosjes – nga njohuria gjithnjë e pranishme për vuajtjen palestineze. Kjo është, pjesërisht, mënyra se si fshihet një popull: është aq e vështirë kur i qëndron besnik identitetit të dikujt saqë, t'ua mësosh gjuhën tënde fëmijëve, kjo shihet si bartje e vuajtjeve.

Përvoja ime e diskriminimit vjen pavarësisht privilegjit të lëkurës sime të bardhë, theksit tim evropian, trashëgimisë sime të krishterë dhe jo myslimane, si dhe nënshtetësisë sime italiane dhe britanike. E shkruaj këtë duke e ditur se kam punë, financa të qëndrueshme dhe kolegë mbështetës. E, megjithatë, është e rrezikshme të flasësh si palestineze – si çdo palestinez tjetër. Kemi parë njerëz që humbin punën, refuzohen nga ngjarjet dhe heshten sepse u bashkuan me zërat që bënin thirrje për paqe, për armëpushim, për të drejtat e qenieve njerëzore dhe duke kritikuar dhunën ushtarake izraelite. Simbolet palestineze, si kufja, janë ndaluar në disa vende, me shumë ekspertë që i barazojnë marshimet në mbështetje të palestinezëve me marshimet për mbështetje të terrorizmit apo edhe kundër hebrenjve. E gjithë kjo e përforcon racizmin anti-palestinez.

Çfarë do të thotë të jesh palestinez? Ka shumë përgjigje. Ekziston realiteti për ata që jetojnë në territoret e pushtuara palestineze të Bregut Perëndimor dhe të Gazës dhe të Jerusalemit Lindor; për ata që si qytetarë jetojnë brenda shtetit të Izraelit; dhe, ata prej nesh që përbëjnë diasporën. Nuk mund të flas në emër të të gjithëve, prandaj, duke parë nga siguria që ofron Britania e Madhe, pyes veten se çfarë do të thotë për mua të jesh palestineze.

Duke u përpjekur për t'u përgjigjur, gjej strehë në shkrimet e Mahmoud Darwishit dhe Edward Saidit, të gjigantëve që hulumtuan këtë pyetje nga pozicioni i diasporës. Kemi përvojë të përbashkët mërgimi, nostalgji dhe mall. Në zërat e tyre dëgjoj zërin e babait tim. Ata kanë lindur në Palestinë, para vitit 1948, ishin burra që ndiheshin të izoluar dhe që vdiqën larg vendlindjes.

Nuk ishte vetëm zhvendosja fizike – ose mërgimi i jashtëm, siç e përkufizoi Darwishi – që la gjurmë në përvojën e tyre. Ishte edhe e brendshme. "Mërgimi", shkroi Darwishi, "ekziston në vetveten që është privuar nga mendimi dhe fjala e lirë, nga ajo që imponohet nga regjimi shtypës dhe shoqëria po aq shtypëse. Njeriu e gjen veten të mërguar në shoqërinë e vet".

Në të gjitha shoqëritë ka ekstremistë që duhen dënuar, por tendenca për të ngatërruar të gjithë palestinezët me ekstremizmin, të gjithë neve na privon nga liria e fjalës. Heshtja e tillë është formë e mërgimit psikologjik. Nuk është thjesht përvojë çnjerëzore; ajo e ndez frikën ekzistenciale. Sepse, pas shpronësimit, vrasjeve dhe shpërnguljeve me forcë, ekzistenca e shumë palestinezëve si palestinezë varet nga liria për të menduar dhe për të folur.

Asgjësimi i vazhdueshëm i Gazës po e bën më të njëtrajtshme përvojën palestineze. Pavarësisht se ku jetojnë palestinezët, dhuna që dëshmojmë na bashkon të gjithëve. Mbrojtja e palestinezëve është më e rëndësishme tash se kurrë, për të kundërshtuar përhapjen e formës së vjetër – por, në rritje – të diskriminimit: racizmit anti-palestinez. Qoftë nëse dikush është publikisht palestinez apo ndryshe.

**/Telegrafi/**

# DOKUMENTE BRITANIKE PER DEMONSTRAT E VITIT 1981 NË KOSOVË (16)



Prof. dr. Sabit SYLA &
Prof. dr. Hamit KABA

Për dijeni: P. Rennie Esq
Departamenti i Kërkimit, FCO

**Organizatorët e demonstratave të dënuar në Prishtinë**

Gazeta Borba, e hëne, 3 gusht 1981, p. 12 c. 1-3
(Prishtinë, 2 gusht)
Këshilli i Gjykatës së Rrethit ka shpallur sot dënimin për një grup prej 11 personash me akuzën se kanë marrë pjesë në organizimin e demonstratave armiqësore dhe kundërrevolucionare më 2 prill 1981, sipas platformës dhe irredentizmit të nacionalizmit shqiptar dhe me dhunë morën armë nga një automjet i Sekretariatit të Punëve të Brendshme, 13 km larg autostradës Prishtinë-Podujevë, në fshatin Besi, dhe/ose kanë ndihmuar fajtorët e kësaj vepre penale për të fshehur armët.
Në bankën e të akuzuarit ishin Zymber Krasniqi (i datëlindjes 1960), nga fshati Breznicë, fermer, Bajram Syla (i datëlindjes 1963), student i shkollës së mesme, nga fshati Rimanista, Q!erim Arifi (i datëlindjes 1961), fermer, nga fshati Rimanistë, Nagip Bllaca (i datëlindjes së 1962), fermer nga fshati Besi, Naim Statovci (i datëlindjes 1962), student nga fshati Prugovc, Sadik Dragusha (i datëlindjes 1949), fermer nga fshati Prugovc, punëtor në Ndërmarrjen e Ndërtimit "Izgradnja" nga Peja, kantier ndërtimi në Prishtinë, Ramadan Rexha (i datëlindjes 1922), fermer nga fshati Rimanishtë, Enver Koliqi (i datëlindjes 1955), nga fshati Lupç i Poshtëm, i papunë, dhe Sadri Berisha (i datëlindjes 1942), nga fshati Drenovc, punëtor i Kombinatit nga Obiliqi.
Për kryerjen e veprave penale të kundërrevolucionit që rrezikojnë rendin shoqëror, sipas Nenit 114 të Kodit Penal të RSFJ, Këshilli i Gjykatës së Rrethit të Prishtinës ka administruar, bazuar në provat e përftuara nga padia, dënimet në vijim: Zymber Krasniqi dhe Nexhmedin Pireva janë dënuar me 13 vjet burgim secili, Bajram Syla dhe Nagip Bllaca janë dënuar me 12 vjet burgim secili, Naim Statovci dhe Sadik Dragusha me 10 vjet secili, Qerim Arifi dhe Enver Koliqi janë dënuar me nga 8 vjet.
Për veprën penale të ofrimit të ndihmës për rrëmbimin e armëve, sipas Nenit 137, paragrafi 1, i Kodit Penal të RSFJ, u dënuan me 7 vjet burgim Shaban Dragusha dhe Ramadan Rexha. I fundit prej tyre Sadri Berisha, u dënua me një vit burgim, sipas veprës penale të fshehjes së armëve, bazuar në Nenin 154, paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës.
Tashmë janë të njohura faktet për ngjarjet në fshatin Besi, afër Prishtinës, për të cilat u përhapën zërat menjëherë pas demonstratave. Konkretisht, sipas akuzës, deponimeve të dëshmitarëve dhe të akuzuarve, u provua në seancën kryesore në Gjykatën e Rrethit të Prishtinës, se tetë personat e akuzuar sipas Nenit 114 të Kodit Penal të RSFJ, në mes të cilëve veçanërisht Zymber Krasniqi dhe Bajram Syla, kanë qenë aktorët kryesorë në organizimin e demonstratave në fshatin Besi, në të cilat morën pjesë me dhjetëra persona të tjerë. Këta tetë demonstrues ishin gjithashtu zhurmëmëdhenjtë që thërrisnin parullat armiqësore "Kosova - Republikë", "Kushtetutë", "Republikë me paqe ose me forcën e armëve", si dhe shumë parulla të tjera nga platforma e nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar.
Ky grup u angazhua në aktivitete armiqësore më 2 prill, nga 11 deri në 16 orë. Ata goditën me gurë shumë automjete që kalonin në rrugën kryesore Prishtinë-Podujevë në atë kohë. Sidoqoftë, ky nuk ishte fundi i dhunës së grupit që qëndronte në këtë anë të rrugës. Me shkopinj në duar, Zymber Krasniqi dhe Bajram Syla, të cilët kishin marrë një flamur të kombësisë shqiptare më parë në shkollën publike në fshatin Besi, ndaluan më pas një kamion, e parkuan atë në rrugën kryesore dhe bllokuan plotësisht trafikun.
Ndërkohë, nga Prishtina po vinte për në Podujevë një varg makinash të Sekretariatit Federal të Punëve të Brendshme. Nën drejtimin e Zymber Krasniqit dhe Bajram Sylës grupi sulmoi një prej automjeteve dhe mori prej tij disa armë, një sasi municionesh dhe mjete të tjera. Se sa e paramenduar ishte kjo lëvizje, është provuar nga fakti se grupi, pasi mori armët me forcë, shkoi me një grup më të madh demonstruesish në një pyll aty afër dhe filloi t'i stërviste me armët e kapura. Natyrisht, në këtë "stërvitje" janë qëlluar disa fishekë në ajër.Gjithsesi, duhet përmendur se kjo "histori" nuk mori fund nga oficerët e Sekretariatit të Punëve të Brendshme, pasi ata ishin të vetëdijshëm se çdo përpjekje për të ndaluar plaçkitjen e armëve do të shkaktonte gjakderdhje.
Mirëpo, keqbërësit nuk ndaluan menjëherë plaçkitjen e armëve dhe municioneve si dhe stërvitjen me armë. Ata shkuan në shtëpi dhe i fshehën armët dhe municionet. Por kjo zgjati vetëm për pak kohë. Agjencitë e ndjekjes ishin shumë pranë gjurmëve të tyre, i arrestuan dhe gjetën armët. Gjatë këtij zbulimi ata gjetën dy armë automatike tek Zymbar Krasniqi, një prej aktorëve kryesorë të këtij aksioni armiqësor, që synonte rrëzimin e sistemit tonë vetë-menaxhues, shkatërrimin e unitetit, vëllazërisë dhe barazisë së kombit dhe kombësive tona. Një armë u gjet tek Bajram Syla, e po kështu Qerim Arifi kishte marrë një armë, një çantë me pajisje të tjera dhe 60 fishekë. Nagip Bllacës iu gjet gjithashtu një armë automatik dhe municion; Naim Statovicit iu gjet një armë dhe 70 fishekë. Sadik Dragusha kishte marrë gjithashtu një armë gjysmë-automatike dhe 10 fishekë, dhe Nexhmedin Pireva – i cili ishte dënuar më parë për disa vepra penale, mori së bashku me Enver Koliqin një armë automatik, një çantë me pajisje dhe 80 fishekë. Shaban Dragusha u akuzua se kishte marrë nga një person një armë automatik me pajisje dhe 150 fishekë, të cilat i kishte fshehur në papafingon e shtëpisë së tij në fshatin Prugovc. Në vend që të raportonte dhe të dorëzonte armën, Shaban Dragusha – i cili ishte dënuar edhe më parë për fshehjen e armëve – pengoi qëllimisht zbulimin e keqbërësve dhe armëve. Të njëjtën vepër ka kryer edhe Ramadan Rexha, i cili e dinte se ku i kishte fshehur dy armë dhe gjashtë fishekë Bajram Syla dhe nuk vuri në dijeni askënd për këtë fakt. Personi i fundit i të akuzuarve sipas Nenit 154 të Kodit Penal të Kosovës, Sadri Berisha nuk mori pjesë në këtë aksion armiqësor, por e dorëzoi armën dhe 70 fishekë që ia kishte dhënë një person tjetër, në zyrën e pushtetit lokal, por gjithsesi e bëri këtë vetëm pas 12 ditësh, duke kryer kështu veprën penale të fshehjes.
Firma Energo-Project në listën kryesore botërore
Gazeta "Borba", e diel, 2 gusht 1981, p. 3 c. 1- 4
(Beograd, 1 gusht)
Në botimin e korrikut të revistës së njohur amerikane "Engineering News Record" u paraqit edhe këtë vit një listë kryesore e firmave, të cilat i ofronin botës punë këshillimore dhe punë të plota inxhinierike. Si zakonisht, listat janë përpunuar në përputhje me rezultatet e biznesit gjatë vitit të mëparshëm. Në mesin e 50 firmave drejtuese në botë për punë këshillimore, firma "Energo-Project" renditet mjaft lart në këtë listë, e 37-ta, me një biznes prej 11.7 milion dollarësh në këtë fushë. Firma "Energo-Invest" ka ende rezultate të mira në klubin e firmave të mëdha, e madje ka përmirësuar vendin e saj krahasuar me vitin e mëparshëm; kjo pasi parashikohet që projekti i kontraktuar së fundmi, që është mbikëqyrja e projektit "Mosul" në Irak për rreth 30 milion dollarë, do të rrisë në mënyrë të konsiderueshme vitin e ardhshëm biznesin disi të mirë të këtij viti.
Dënimet e shpallura në Mitrovicë (Gazeta "Borba", e enjte, 30 korrik 1981, p. 12 c. 1)
Mitrovicë, 29 korrik: Në përfundim të seancës dëgjimore kryesore, e cila filloi dje, trupi gjykues i Gjykatës Krahinore të Mitrovicës shpalli sot dënimet e pesë personave të akuzuar për aktivitet armiqësor dhe për organizimin dhe pjesëmarrjen në demonstrata armiqësore dhe kundërrevolucionare. Tekniku i papunë nga fshati Shupkofc, Xhelal Ferizi, i akuzuar për veprën penale sipas Nenit 136, paragrafi 1, dhe Nenit 114 i Kodit Penal të RSFJ, është dënuar me 8 vjet e 6 muaj burgim. Personi tjetër i akuzuar për të njëjtat vepra, Ujkan Zeneli, 19 vjeç, nxënës i shkollës së mesme në qendrën "Desa Tomoviq" në Mitrovicë, u dënua me 8 vjet burgim. Personi i tretë, Skënder Hajredini, punëtor i Elektrolizës së zinkut në Mitrovicë, u dënua me 7 vjet dhe 6 muaj burgim për kryerjen e veprës penale sipas Nenit 136, paragrafi 2/a, dhe Nenit 114 të Kodit Penal të RSFJ. Sabit Veseli, teknik i papunë nga fshati Broboniq u dënua me 7 vjet burgim për të njëjtat vepra penale. Anëtari i pestë i këtij grupi, Nazim Shaqiri, student i shkollës së mesme teknike në Mitrovicë, u dënua me 6 vjet e 6 muaj burgim.

**-83-**
**Konfidenciale**

A. E. Montgomery Esq
Departamenti Sovjetik dhe i Evropës Lindore
Ambasada britanike
Zyra e Jashtme dhe e Komonuelthit
Beograd
10 gusht 1981
I nderuar Alan,

**Kosova: përgjegjësia politike**
**Përmbledhje**

1. Riorganizimi i shumëpritur i udhëheqjes së Kosovës ndodhi në mbledhjet e Kuvendit të Kosovës dhe Komitetit Krahinor të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës, respektivisht më 4 dhe 5 gusht. Kryetari i ri i Kryesisë së Kosovës, Ali Shukrija, një shqiptar "federal i provuar si dhe Kryesia e re dhe e reduktuar e Partisë prej 13 anëtarësh tregon gjithashtu rikthimin e një numri kosovarësh të besuar "federalë" përveç anëtarëve të rizgjedhur më pak të debatueshëm të Kryesisë së vjetër. Është shprehur njëfarë optimizmi për situatën politike dhe të sigurisë si dhe është rënë dakord për detyra të ardhshme në fushën e emigrimit, arsimit dhe →



ekonomisë. Gazeta "Politika" është edhe një herë në telashe pasi ka nxjerrë informacione Konfidenciale (për Bakallin). Efektet e ngjarjeve për anëtarët e Partisë janë zbuluar në statistikat më të fundit.

Detaje

Mbledhja e Kuvendit të Kosovës

2. Më 4 gusht u mblodhën të tri dhomat e Kuvendit të Kosovës dhe "në mënyrë unanime dhe pa diskutim" zgjodhën Ali Shukrinë si Kryetar i Kryesisë së Kosovës, i cili zëvendësoi Xhavit Nimanin, për dorëheqjen e të cilit kam shkruar në letrën time të datës 21 korrik. Siç tregon përfaqësuesi ynë i përhershëm aty, Shukrija është një burrë i madh shteti i aftë dhe i paepur, i cili ka kaluar pjesën më të madhe të karrierës së tij politike në Beograd. Ai përfaqëson modelin "jugosllav" të partizanëve dhe duhet të shikohet si një kandidat federal me detyrë rindërtimin dhe riintegrimin e Kosovës në Serbi dhe në Federatë.

3. Kuvendi bëri gjithashtu edhe ndryshime të tjera. Dr. Zeki Bejtullahu u shkarkua nga postet e tij si anëtar i Këshillit Ekzekutiv të Kosovës dhe si Drejtor i Institutit për Planifikimin Social me argumentin se nuk i ka kryer këto funksione mirë, veçanërisht këtë të fundit, ku ai është kritikuar për mënyrën se si ka zbatuar planin afatmesëm. Shaban Hyseni, Kreu i mëparshëm i Radio Prishtinës, i cili e kishte paraqitur dorëheqjen e tij (shih letrën e Charles Crawford të datës 18 korrik), u pushua menjëherë nga posti për sjellje të papërgjegjshme dhe oportuniste. Gjithashtu Mustafa Osmanagiq i cili përshkruhej si një punëtor i shquar socio-politik nga Mitrovica, u zgjodh në Këshillin e Kosovës.

4. Sidoqoftë, shtypi u ndal më gjatë në një sulm të hapur që është bërë nga tre anëtarë shqiptarë ndaj Dushan Ristiqit (serb), Kryetar i Kuvendit. Ata kërkuan dorëheqjen e tij me argumentin se ishte në përgjithësi përgjegjës njësoj si Nimani dhe Bakalli dhe se kishte luajtur rolin e "mbrojtësit të serbëve dhe malazezëve" dhe kishte nxitur çështjen e emigrimit të këtyre të fundit nga Kosova. Ishte vendosur se kjo çështje nuk ishte e përshtatshme për diskutim në Kuvend por që duhej diskutuar të nesërmen në mbledhjen e Komitetit Krahinor. Megjithatë, duket se Ristiq ka marrë vetë iniciativën për ngritjen e kësaj çështjeje aty dhe bëri një deklaratë duke pranuar përgjegjësinë e tij personale dhe kolektive për ngjarjet në Kosovë gjatë muajve të fundit dhe duke vendosur të paraqiste dorëheqjen e tij në mbledhjen e ardhshme në Kuvend. Ai bëri të qartë se vendimi i tij ishte i pakthyeshëm dhe duket se nuk ka pasur diskutime në këtë pikë apo ndonjë përpjekje për t'i kthyer mendjen. Ai theksoi gjithashtu se nuk po largohej për shkak të sulmit të ditës së mëparshme ndaj tij, duke deklaruar se i qëndronte çdo gjëje që ka thënë për çështjet në diskutim. Në të vërtetë, Ristiq ka qenë tejet i hapur në kritikën e tij ndaj nacionalizmit shqiptar dhe presioneve ndaj serbëve dhe malazezëve për t'u larguar nga Kosova, por padyshim ai duhej fajësuar po aq për situatën për faktin që nuk ngriti zërin deri më vonë (ose ndoshta e paralajmëroi Beogradin më parë, por nuk i kushtoi vëmendje arsyeve më të gjera politike). Prandaj, largimi i tij duhet parë si një përpjekje e bërë nga shqiptarët për të treguar se ata nuk duheshin fajësuar ekskluzivisht për çfarë kishte ndodhur. Ai është serbi i dytë i njohur që jep dorëheqjen (tjetri është një prej zëvendës/Rektorëve të Universitetit të Prishtinës) dhe dyshoj se do të kishte ikur nëse nuk do të ishte shtyrë për ta bërë një gjë të tillë.

5. Në mbledhje të veçanta të Dhomës socio-politike dhe Dhomës së Komunave, u zgjodh Sekretari për Punët e Brendshme, Milosh Vujakoviq (serb ose malazez), ish anëtar i Kryesisë së Sindikatave të Kosovës, i cili zëvendësoi shqiptarin që kishte dhënë dorëheqjen më parë. Prokurori Publik ishte liruar nga detyrat e tij "për shkak të transferimit në funksione të tjera" dhe u zgjodh një tjetër. Gjithashtu u zgjodh një Mbrojtës i ri Publik. Nga ana tjetër, delegatët nuk ishin në gjendje të binin dakord me propozimin për të liruar nga funksionet e tij Drejtorin e Institutit të Statistikave për Kosovën, megjithëse e mbante atë post prej 9 vitesh, dhe vetëm këto ditë u pa e përshtatshme për ta larguar.

Mbledhja e Komitetit Krahinor

6. Detyra e parë e mbledhjes së Komitetit Krahinor më 5 gusht ishte shqyrtimi i programit të veprimit që kishte filluar 3 muaj më parë, por vëmendja e shtypit ishte e pritur të përqendrohej në zgjedhjen e Kryesisë së re. Ishte njoftuar se ishte vendosur të reduktohej anëtarësia e kësaj Kryesia nga 19 në 12, megjithëse sipas numërimit tim në fakt janë 13 anëtarë!

Kryesia e Vjetër

Mahmut Bakalli - Kryetar, dha dorëheqjen

Veli Deva (q.v.)

Xhavit Nimani - kryetari i dorëhequr nga Kryesia e Kosovës

Dushan Rishtiq - kryetari i dorëhequr nga Kryesia e Kosovës

Bahri Oruçi - kryetar i Komitetit Ekzekutiv

Mihajlo Zvicer k ish-kryetar i ASPPS

Asllan Fazllija

Rexhep Zogaj

Sefedin Batalli

Borivoje Zhivageviq

Rabije Bajrami

Asllan Skenderi

Asim Zatriqi

Kryesia e Re

Veli Deva - Kryetar (u zgjodh më 5 maj në vend të Bakallit)

Sinan Hasani - Zëvendës/Kryetar i Kuvendit Federal

Ilijaz Kurteshi - ish-Kryetar i TU-ve serbe



Ilija Vakiq - ish Kryetar i Dhomës Jugosllave të Ekonomisë

Azem Vllasi - Kryetar i Kosovës dhe ish Kryetar i Bashkimit Federativ të Rinisë

Nebi Gashi - Zëvendës/Kryetar i Këshillit Ekzekutiv

Svetislav Vukoviq

Predrag Cuckiq )

Xhevdet Hamza )

Petar Kostiq ) të rizgjedhur

(Sekretar) ) nga

Mustafa Pljakiq ) Kryesia

(Kryetar i TU-ve të Kosovës ) e vjetër

Sinan Sahiti )

Ali Shukrija )

(Kryetari i ri i Kryesisë se Kosovës)

7. Kryesia e reduktuar përmbante së paku gjysmën e atyre që mund të quheshin "federalistë", d.m.th. politikanët që kishin kaluar pjesën më të madhe të karrierës së tyre në Beograd, dhe duhet të shikohen, të tillë si Ali Shukrija, si zgjedhje të sigurta për rindërtimin e Kosovës. Ky reduktim duket se është arritur përmes shkurtimit të numrit të pjesës më të madhe të Kryetarëve të komiteteve të ndryshme të Kryesisë, por nuk u dha asnjë shpjegim se pse një gjë e tillë ishte e nevojshme ose pse disa Kryetarë komiteti ishin mbajtur dhe disa të tjerë jo. Sidoqoftë, Kryesia e re ishte e shpejtë në reagimin e saj, duke mbajtur mbledhjen e saj të parë të nesërmen dhe duke zgjedhur si sekretar të saj ekzekutivë, Beqir Hotin dhe Sava Komadiniq.

8. Megjithatë, pjesa kryesore e mbledhjes iu kushtua shqyrtimit të programit të veprimit nga Sekretari, Petar Kostiq. Ai pretendoi se, megjithë problemet dhe vështirësitë e shumta, ky program kishte hedhur themele të shëndosha dhe LKK i konsideroi arritjet e saj me optimizëm të moderuar megjithëse në të njëjtën kohë edhe më pakënaqësi për faktin se nuk kishte arritur nivelet e pritshme të "konsolidimit". Ai tha se situata politike dhe e sigurisë ishte e favorshme, megjithëse ende e ndërlikuar. Kjo situatë ishte e favorshme në sensin që armiku ishte thyer dhe dëbuar nga rrugët, por ende nuk ishte shkatërruar, dhe organizatat e Partisë po punonin në mënyrë të drejtpërdrejtë kudo me njerëzit, gjë që nuk kishte ndodhur më parë. Kjo situatë mbeti e ndërlikuar sepse parullat - "Kosova, Republikë" - vazhdonin të shfaqeshin, pamfletet vazhdonin të qarkullonin duke e denigruar Jugosllavinë, duke bërë thirrje për revoltë dhe duke nxitur armiqësinë ndaj komuniteteve të tjera; gjithashtu, u bënë sulme ndaj pronës dhe jetës së njerëzve në disa fshatra me objektivin për të ruajtur atmosferën e tensionit deri kur Kosova të bëhej Republikëme çdo mjet. Ky aktivitet mbështetej nga propaganda e zhvilluar nga Shqipëria dhe nga organizatat shqiptare dhe ustashe të emigrantëve. Organizatat komuniste në disa zona po merrnin masa të suksesshme kundër këtij aktiviteti por tjetërkund ato ishin të dobëta, madje ishin shpërndarë dhe procesi i spastrimit po zhvillohej ngadalë. Kostiq veçoi organizata të ndryshme në komunat e Pejës, Deçanit, Vitisë, Ferizajt dhe Universitetit të Prishtinës (megjithëse aty ishin bërë disa përmirësime), organizata të industrisë elektrike dhe organizatën e ndërtimit "Ramiz Sadiku" si organizata në veçanti të pakënaqshme.

9. Kostiq theksoi tri fusha të aktivitetit të veçantë për LKK: marrëdhëniet ndër-komunale, sistemin arsimor dhe ekonominë. Ai vuri në dukje se pothuaj kudo në Kosovë kishte pasur ftohje të marrëdhënieve midis komuniteteve dhe theksoi nevojën për të ndaluar emigrimin e serbëve dhe malazezëve, veçanërisht të atyre me kualifikimet e nevojshme për ekonominë.

10. Duke iu kthyer sistemit arsimor ai renditi çështjet bazë për të cilat nevojiteshin vendime: diferencimi ideo-politik në radhët e stafit mësimdhënës dhe largimi i të gjithë atyre që nuk kishin cilësitë e duhura morale dhe politike dhe atyre që ishin rrënjosur me besime nacionaliste, zëvendësimi i një numri të madh personash të pakualifikuar me personel të përshtatshëm, si dhe shqyrtimi analitik i bazës Marksiste të kurrikulave dhe teksteve shkollore. Masat në këto fusha janë në zhvillim e sipër për t'i vënë tekstet shkollore në shkolla dhe në universitet në linjë me ato që përdoren në Serbi; gjithashtu u mbajtën seminare me stafin mësimdhënës në të gjitha komunat, përveç Pejës kryesisht si pjesë e riedukimit të tyre.

11. Duke folur për ekonominë, ai përmendi rënien e produktivitetit dhe realizueshmërisë; Kosova tani mbulonte vetëm 46.7% të importeve të saj me eksportet dhe me tregun e monedhës së konvertueshme vetëm në masën 17.5%. Sidoqoftë, ai nuk doli me zgjidhje të reja dhe, siç ishte njoftuar një ditë më parë në Kuvend, versioni i rishqyrtuar i planit të tërhequr 5-vjeçar do të ishte tani gati për diskutim deri më 30 shtator me qëllim paraqitjen e këtij plani në fund të nëntorit!

12. Nuk pati ndonjë gjë të re në debatin në vijim, përveç disa pikave që theksuan se nacionalistët nuk ishin mundur aspak. Një folës tha, "megjithëse armiku është përçarë ai po e rrit aktivitetin e tij dhe i përgjigjet të gjitha veprimeve tona me kundër-veprime përkatëse, të cilat zhvillohen në vende të ndryshme, por që qartazi ato janë koordinuar nga një vend". Folës të tjerë përmendën se në bisedimet me studentët dhe mësuesit ishte e qartë se kishte ende mbështetje për pikëpamjet nacionaliste shqiptare. Ndoshta më interesantja nga të gjitha, është se Veli Deva konfirmoi për herë të parë në fjalimin e tij dredhues se ishin zhvilluar sulme ndaj JNA (Forcave të Armatosura).

13. Siç raportoi Charles Crawford javën e kaluar në përmbledhjen e tij të marrëdhënieve me shtypin, ka pasur një farë rënieje në interesin e shtypit në Kosovë, por gazeta "Politika" ka hyrë përsëri në telashe duke publikuar në prag të mbledhjes së Komitetit Krahinor një përshkrim të mirë-informuar të dokumenteve bazë që do të shqyrtohen. Gazeta "Politika" dha në detaje gjetjet e Komisionit të veçantë të ngritur për të përcaktuar përgjegjësinë politike të Bakallit për gabimet dhe mosveprimet që çuan në



shpërthimin e nacionalizmit në Krahinë. Në veçanti, Komisioni shqyrtoi faktin përse Komitetet Qendrore të Jugosllavisë dhe Serbisë nuk ishin informuar për pamfletet armiqësore, informacionet dhe shkresat nga Prishtina, Gjakova dhe Ulqini (Mal të Zi), të cilat ishin marrë nga Bakalli dhe të tjerë dhe nuk ishin paraqitur për analizën e duhur. Bakalli e kishte justifikuar këtë përpara Komisionit, duke thënë se ato ishin anonime dhe se ai po priste për të bërë hetime të mëtejshme për to. Shumë çështje të tjera që prej vitit 1979, kur armiku po rriste aktivitetet e tij, nuk u vunë asnjëherë në agjendë për diskutim dhe gjërat u lejuan të vazhdonin në të njëjtën mënyrë të vjetër. Këtyre gabimeve iu shtua trajtimi i 55 personave të arrestuar në fund të vitit 1979 apo në fillim të vitit 1980 (të dhëna të cilat gazeta "Politika" i nxori në atë kohë – shih letrën time të datës 2 prill 1980 për Christopher Battiscombe). Ishte rënë dakord që të gjithë këta persona me përjashtim të 19 prej tyre duheshin liruar dhe, në vend që të vuanin dënimin për aktivitetet e tyre armiqësore, ata u lejuan të vazhdonin studimet, madje 23 prej tyre morën edhe bursa! Përfundimisht, Komisioni shënoi se çështja e nacionalizmit nuk kishte qenë në agjendën e Kryesisë gjatë dy viteve të fundit. Mbledhja nxori konkluzione se përgjegjësia e Bakallit ishte e padiskutueshme dhe propozoi që ai të përjashtohej nga Komiteti Krahinor dhe t'i bëhej një paralajmërim i fundit përpara se të përjashtohej nga LK.

14. Asnjë nga këto detaje nuk u zbulua në raportimin për vetë mbledhjen dhe shqetësimi i anëtarëve për rrjedhjen e informacioneve u shpreh në vendimin e tyre për të ngritur një Komision tjetër që do të përcaktonte se si ndodhi që gazeta "Politika" publikoi materiale tepër Konfidenciale për përgjegjësinë politike të Bakallit. Kështu, përsëri gazeta "Politika" do të vihet në bankën e të akuzuarve pasi e ka marrë lirinë e shtypit në kuptimin e mirëfilltë të fjalës.

15. Përfundimisht, për të bërë bilancin eventual për Kosovën, u nxorën disa statistika më shumë nga Komiteti Krahinor. Deri tani janë përjashtuar 534 anëtarë nga LK. Një numër tjetër i rëndësishëm anëtarësh (jo për Kosovën në tërësi, por vetëm për Prishtinën ky numër ishte 364), është hequr nga listat e LK, d.m.th. anëtarësia e tyre ka përfunduar për shkelje të vogla, për shembull mos-pagimi i kuotizacionit, mos-shkuarja në mbledhje, etj. Gjithashtu, 269 nxënës dhe studentë janë përjashtuar nga shkollat e mesme dhe të larta, duke humbur kështu bursat e tyre të studentit si dhe bursa të tjera. Po kështu, 210 persona, kryesisht staf mësimdhënës, janë pushuar ose pezulluar nga puna. Procesi i diferencimit vazhdon dhe duhet hartuar ende një përmbledhje përfundimtare.

I Juaji
T. J. Clark
Për dijeni: P Rennie Esq
Departamenti i Kërkimit; FCO; Kancelari; UKDEL NATO; Bruksel

**84-**
**Zyra e Jashtme dhe e Komonuelthit**

Beograd
Londër SW1A 2AH
11 gusht 1981
T. J. Crark Esq CVO
I nderuar Terry,

**Kosova: situata e sigurisë**

1. Ju falënderoj shumë për shkresën tuaj të datës 28 korrik ku keni përfshirë raporte shumë interesante të amerikanëve për situatën në Kosovë. Jam dakord se në përgjithësi ato tingëllojnë të vërteta megjithëse duket se ka një mospërputhje midis deklaratës së ushtarëve të rinj sipas së cilës ushtarët kanë marrë urdhra të rreptë për të shmangur shqetësimet dhe veçanërisht për të mos përdorur armë zjarri dhe pretendimit për inkursione ndëshkimore kundër fshatrave shqiptare. Megjithatë, tabloja e përgjithshme përbën një problem të madh që ka të ngjarë t'i paraqesë autoritetet federale jugosllave me vështirësi të vazhdueshme për një periudhë të gjatë në të ardhmen.

2. Lejomëni të përfitoj nga rasti (që erdhi nga një çlirim i çastit në presionin e vazhdueshëm të shkaktuar nga zhvillimet në Poloni) t'ju falënderoj ju dhe pjesën tjetër të Zyrës së Kancelarit të Beogradit për raportimin tuaj shumë të plotë mbi Kosovën. Mendojmë se keni shërbyer shumë mirë dhe mund t'ju siguroj se të gjitha raportet e juaja janë lexuar me kujdes dhe vëmendje edhe nëse nuk janë pranuar gjithmonë.

I Juaji
A. E. Montgomery
Departamenti Sovjetik dhe i Evropës Lindore

**-85-**
**Zyra e Jashtme dhe e Komonuelthit**

Beograd
Londër SW1A 2AH
12 gusht 1981
T. J. Crark Esq CVO
I nderuar Terry,

**Kosova: Treguesi II**

1. Ju falenderoj shumë për informacionin e Ambasadorit mbi vazhdimin e tensionit në Kosovë. Këtë informacion e kam paraqitur dhe shpërndarë gjerësisht në të gjitha seritë departamentale.

2. Më duket se kam zbuluar në tonin e informacionit të Ambasadorit një notë më të mprehtë shqetësimi (të cilin e kemi edhe ne) se tensioni aktual po bie shumë më ngadalë nga ç'mund të jetë shpresuar, dhe se ka të ngjarë që për një farë kohe të vazhdojë rreziku i përsëritjes, megjithëse ndoshta sporadike të shpërthimeve të trazirave. Sidoqoftë, më shqetësues është konkluzioni me të cilin vështirë të mos bihet dakord, se autoritetet federale po përballen këtu me një prej problemeve të gjata të pakicave, ku edhe pse pas pakënaqësisë aktuale thuhet se këto probleme janë zgjidhur, nacionalizmi lokal, pakënaqësia e vazhdueshme dhe tendenca demografike (të cilave do t'i shtonim varfërinë e vazhdueshme relative të Kosovës) do të vazhdojnë të tensionojnë marrëdhëniet midis Kosovës dhe Republikave të tjera. Përshtypja jonë në këtë rast është se shumica e jugosllavëve do të pranonin që Kosova (si Ulster) nuk është e përshtatshme për një zgjidhje në kuptimin e një hapi të përcaktuar qartë, një herë e përgjithmonë, që do të kënaqte plotësisht të gjitha palët e përfshira. Ndoshta ajo që jugosllavët mund të shpresojnë më shumë është që të mbajnë manifestimet e pakënaqësisë së Kosovës brenda limiteve të menaxhuara, ndërkohë që do të bënin të pamundurën për të lehtësuar kufirin e saj ekonomik përmes nxitjes së industrisë së re.

3. Mendoj se ishte e pashmangshme që përballja në Kosovë dhe sensacionalizimi në shtyp i vështirësive me të cilat janë ballafaquar serbët që jetojnë aty, duhet të ketë provokuar rigjallërimin e nacionalizmit serb. Për këtë arsye, do të jetë me interes për të parë nëse në aspektin afatgjatë do të shfaqen më me forcë problemet e tjera kombëtare të Jugosllavisë. Shpresojmë që të jetë e vërtetë e kundërta dhe Republikat e tjera, ashtu si udhëheqja kolektive, të mund të përfitojnë, siç e ka sugjeruar Ambasadori, në sensin pozitiv nga impulset për ruajtjen e integritetit të Jugosllavisë. Padyshim shembulli kosovar duhet t'u ketë kujtuar jugosllavëve në tërësi rrezikun se mund të qëndrojnë të ndarë nëse nuk arrijnë të bashkohen të gjithë, duke i dhënë kështu një stimul idealit të unitetit të popujve sllavë të jugut. Për shembull, kohët e fundit na është sugjeruar nga Chris Cviiç se reagimi i ashpër i Maqedonisë ndaj kërcënimit shqiptar për Republikën maqedonase mund të ndihmonte për të zhdukur ndjenjat e mbetura anti-serbe në Maqedoni. Nga ana tjetër, edhe nacionalistët më të zjarrtë serbë, të cilët ankoheshin për humbjen e Maqedonisë, mund të afrohen sot më mirë me maqedonasit me të cilët kanë sfidën e përbashkët ndaj kosovarëve jo-sllavë. Është me interes të dimë mendimin tuaj.

4. Por, sipas mendimit tim, vështirësia më e madhe për udhëheqësit jugosllavë është ajo e pajtimit të krenarisë serbe me nacionalizmin kosovar. Jugosllavia,si Federatë shumëkombëshe, ndryshe nga shumica e shteteve unitare, ka në dispozicion një përgjigje të gatshme ndaj pohimeve nacionaliste të këtij lloji, më specifikisht autonominë e madhe. Për një të jashtëm, zgjidhja e qartë do të ishte që kosovarëve t'u jepet statusi i Republikës me qëllim që t'i pritet rruga irredentistëve shqiptarë. Por një zgjidhje e tillë do të ishte tërësisht e papranueshme për Serbinë.

I Juaji
A. E. Montgomery
Departamenti Sovjetik dhe i Evropës Lindore

**-86-**
**Konfidenciale**

021/8
Ambasada britanike
Departamenti Sovjetik dhe i Evropës Lindore
Athinë
FCO
12 gusht 1981
I nderuar Departament,

**Kosova**

1. Duhet ta kini vënë re deklaratën e Kryeministrit jugosllav gjatë vizitës së tij në Athinë në korrik (paragrafi 9 i përkujtesës së Ambasadorit i datës 21 korrik) ku shprehej se rusët kanë nxitur trazirat në Kosovë. Kjo pikëpamje është pasqyruar më tej në paragrafin 13 të njoftimit të Ambasadorit të Madhërisë së Saj në Beograd më 29 qershor dhe paragrafin 12 të njoftimit të tij më 1 korrik.

2. Duke pasur parasysh interesin e veçantë grek në këtë problem përfitova nga rasti dhe pyeta Kalpadakis (zëvendës/drejtor i Departamentit të Evropës Lindore pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme) për reagimet greke në këtë drejtim. Ai tha se pohimi i Gjuranoviq i kishte zënë tërësisht të befasuar. Grekët nuk kishin prova nga ndonjë burim për të sugjeruar për përfshirjen e sovjetikëve, megjithëse nuk mund të përjashtohej mundësia e përzierjes së tyre me disa nga grupet nacionaliste. Në lidhje me temën e përfshirjes së shqiptarëve, Kalpadakis tha se nuk kishte për të shtuar asgjë në vlerësimin që Mazarakis i kishte dhënë Llewellyn Smith më 20 maj (letra e Llewellyn Smith drejtuar Broomfield më 20 maj).

3. Ky është këndvështrimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme. Në bisedën me Ambasadorin, Averoff (Ministri Grek i Mbrojtjes dhe Zëvendës/Kryeministër) ka thënë se besonte që rusët do të shfrytëzonin çdo rast për të nxitur shqetësime midis Shqipërisë dhe fqinjëve të saj. Ai shtoi se nuk do tëçuditej nëse harta e Shqipërisë, sipas grekëve referuar në letrën e Michael Llewellyn Smith të datës 19 qershor drejtuar Battiscome, të ishte pjesë e operacionit të KGB, megjithëse ai nuk pretendonte se kishte prova të forta për këtë.

4. Asnjë reagim nuk është për t'u habitur. Ministria e Punëve të Jashtme është e predispozuar të minimizojë raportet mbi vështirësitë e marrëdhënieve midis vendeve të Ballkanit, ndoshta me përjashtim kur bëhet fjalë për bullgarët. Nga ana tjetër, Averoff është gjithmonë i gatshëm për të parë dorën komuniste në problemet e Ballkanit, veçanërisht atë sovjetike. Ne jemi më të prirë për të qenë dakord me Ministrinë e Punëve të Jashtme, veçanërisht nën dritën e vlerësimit të kohëve të fundit të Qendrës së Përbashkët të Informacionit, JIC, për Shqipërinë. Por jemi të interesuar të dimë se çfarë të dhënash kemi, nëse ka ndonjë, mbi përzierjen e sovjetikëve (ose në të vërtetë shqiptarëve).

I Juaji
L. Parker




# Sport


Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Fenerbahçe braktis finalen pas 3 minutash lojë, Galatasaray fitoi Superkupën



Stamboll, 7 prill - Finalja e Superkupës së Turqisë dhuroi një shfaqje të shëmtuar. Fenerbahçe vendosi të largohej nga fusha në minutën e 3-të, pasi Mauro Icardi kishte kaluar në avantazh Galatasarayn në minutën e parë. Fenerbahçe zgjodhi të luante me ekipin U-19, një vendim i marrë pas incidenteve në Trabzon dhe gjithashtu pas kërkesës për të zhvendosur ndeshjen, pasi janë ende në garë në Ligën e Konferencës. Galatasaray fitoi Superkupën në një situatë jo të zakonshme, teksa festuan në fushë sikur gjithçka të kishte ndodhur rregullisht.

# Drita mposhti Llapin, Ballkani rikthehet në pozitën e parë

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

Podujevë, 7 prill - Derbi i zhvilluar në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Podujevë, ndërmjet Llapit dhe Dritës, i ka takuar skuadrës gjilanase (0-1). Rastet ishin të shumta në pjesën e parë nga të dyja skuadrat, por tre minuta pa përfunduar kjo pjesë, golin e parë dhe të vetmin në ndeshje e realizoi Blend Baftiu. Në pjesën e dytë, Llapi mori iniciativën duke rrezikuar më shumë portën kundërshtare, por pa sukses. Në anën tjetër skuadra mysafire u fokusua me shumë në mbrojtje dhe arriti të ruajë epërsinë e pjesës së parë dhe të marrë pikët e plota. Pas kësaj xhiro, Llapi zbret në vendin e dytë në tabelë me 54 pikë, aq sa ka edhe skuadra e Dritës në pozitën e tretë. Kampionia në fuqi, Ballkani është rikthyer në pozitën e parë, pas humbjes së Llapit dhe fitores ndaj Lirisë së Prizrenit, me rezultat 2-0. Golin e parë e shënoi Nazmi Grishi në minutën e 70-të, ndërsa rezultatin final e vendosi kapiteni Edvin Kuç në minutën e 92-të. Ballkani kryeson në renditjen tabelore me 56 pikë, kurse Liria është e fundit me pikë. Në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas, ndërmjet Feronikelit 74 dhe Prishtinës është mbyllur pa fitues dhe pa gola. Të shtunën, Gjilani ka shënuar fitore bindëse ndaj Fushë Kosovës (4-0). Katër golat gjilanasit i shënuan në pjesën e dytë. Serinë e golave e hapi Marko Roganoviq, në minutën e 52-të, për ta vazhduar Oltion Billali (60'), teksa rezultatin përfundimtar e vulosi Senad Jaroviq, me golat e shënuar në minutat 68' e 74'. Ndërkohë, ndeshja e zhvilluar në stadiumin "Liman Gegaj" ndërmjet Malishevës dhe Dukagjinit u mbyll baras 1-1. Të parët në epërsi kaluan mysafirët me golin e Altin Mërlakut, në minutën e 53-të, por baraspeshën në rezultat e riktheu Drilon Hazrollaj, me golin e shënuar në minutën e 77-të.




**SUPERLIGA - Java e 28-të**

Të shtunën takohen:

| | |
|---|---|
| Llapi - Drita | 0-1 |
| Feronikeli 74 - Prishtina | 0-0 |
| Ballkani - Liria | 2-0 |
| Gjilani - Fushë Kosova | 4-0 |
| Malisheva - Dukagjini | 1-1 |

Tabela

| | | Pikë |
|---|---|---|
| 1. Ballkani | 28 | 56 |
| 2. Llapi | 28 | 54 |
| 3. Drita | 28 | 54 |
| 4. Malisheva | 28 | 49 |
| 5. Prishtina | 28 | 40 |
| 6. Dukagjini | 28 | 36 |
| 7. Gjilani | 28 | 30 |
| 8. Feronikeli 74 | 28 | 30 |
| 9. Fushë Kosova | 28 | 20 |
| 10. Liria | 28 | 10 |

# Prishtina dhe Ylli fitojnë ndeshjet e para çerekfinale

Prishtinë, 7 prill - Sigal Prishtina ka fituar ndeshjen e parë çerekfinale të "play-offit" kundër Vëllaznimit me rezultat 72:64 (24:18, 20:22, 13:8, 15:16). "Bardhekaltrit" e nisën ndeshjen më mirë, me një seri të jashtëzakonshme 13:2, por kuqezinjtë iu afruan në rezultat, ku çereku i parë përfundon 24:18. Periudha e dytë ishte më e barabartë, me mysafirët që afruan rezultatin në 40:38, derisa pjesa e parë përfundoi 44:40. Kuqezinjtë vazhduan me lojë të mirë dhe me shtatë pikë radhazi përmbysën shifrat në 44:47, por prishtinasit u rikthyen dhe sërish shkëputën në 57:48, derisa në dhjetë minutat e fundit thelluan më shumë epërsinë, ndërsa triumfuan me rezultat 72:64. Henrik Sirko ishte më i dalluari te vendasit me 18 pikë, tri kërcime e tri asistime, kurse te mysafirët Jordan Dallas shënoi 14 pikë e bëri edhe tetë kërcime. Ndeshja e ardhshme do të zhvillohet në Gjakovë, derisa skuadra që shënon dy fitore kualifikohet në gjysmëfinale, ku i pret Trepça, që ka përparësinë e terrenit vendas. Ndërsa Golden Eagle Ylli ka shënuar fitore në ndeshjen e parë çerekfinale të "play-off"-it ndaj Bashkimit me rezultat 87:69 (18:18, 23:14, 18:22, 28:15). Pas një fillimi ku u shënuan pak pikë, skuadrat filluan të jenë efikase në sulm, megjithatë, çereku i parë përfundon 18:18. Vendasit ishin më shumë produktivë në periudhën e dytë, duke qenë më të mirë se mysafirët, derisa shkuan në pushim me rezultat 41:32. Por, prizrenasit nuk u dorëzuan dhe filluan të shkrijnë epërsinë, që shkoi deri në tri pikë, derisa shifrat pas 30 minutash ishin 59:54. Në dhjetë minutat e fundit, Ylli u tregua më i vëmendshëm, për tu shkëputur dhe për të triumfuar 87:69. Te vendasit u dalluan Alonzo Verge Jr me 26 pikë, shtatë kërcime e 12 asistime dhe Nate Grimes me 13 pikë e 14 kërcime, kurse te prizrenasit më i miri ishte Lejson Zeqiri me 19 pikë e tri kërcime. Në gjysmëfinale kualifikohet skuadra që shënon dy fitore, ku i pret Peja, që ka përparësinë e fushës në gjysmëfinale.



## S'ka fitues në 'Old Trafford'

Manchester, 7 prill - Manchester United dhe Liverpooli dhurojnë spektakël në Premier Ligë, por nuk shkuan më shumë se një barazim 2-2 në "Old Trafford". Pjesa e parë u mbyll 0-1 falë realizimit të Luis Diaz, por skuadra e Jurgen Klopp shpërdoroi një mori rastesh për të dyfishuar shifrat. Unitedi barazoi në fillimin e pjesës së dytë falë një goli shumë të bukur të kapitenit Bruno Fernandes nga mesi i fushës. "Djajtë e Kuq" ndërkohë do të shënonte një tjetër gol të bukur me 18-vjeçarin Kobbie Mainoo. Liverpooli nuk u dorëzua dhe evitoi humbjen falë penalltisë së ekzekutuar saktë nga Momo Salah. Pas këtij barazimi, Arsenali mbetet në krye me 71 pikë, po aq numëron edhe skuadra e Kloppit, ndërkohë që pas tyre vjen City me një pikë më pak.




100%
Fresh &
Natural
VIDAS
Llatte
drink
2%
VIDAS
TAMËL
PRODHUAR ME
FINESË DHE DASHURI
VIDAS
Schmand
ajkë e freskët
sour cream
18% yndyrë
800g
VIDAS
100%
JOGURT
VIDAS
DHALLË
NGA QUMËSHTI I FERMAVE TONA


ROYAL CROWN
RC
cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC
cola
Columbus, Georgia, USA
RC
cola
0.5L

PRISHTINA

**Ndërmarrja Publike Lokale "Prishtina Parking" Sh. A. Prishtinë**

PRISHTINA PARKING

Në bazë të dispozitave të nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës dhe nenit 4 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Ndërmarrja Publike Lokale "Prishtina Parking" SH.A. shpall këtë:

08 -04- 2024
02 Nr. 249/1

## KONKURS PUBLIK

**Për pozitat e punës:**

**I. Recepsionist/e, një (1)**

**Departamenti i Administratës, nr. ref. 04**

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Komunikimi me konsumatorët e shërbimeve të ndërmarrjes në mënyrë të qartë dhe të saktë;
- Pranimi i telefonatave nga qytetarët dhe transferimi i telefonatave në zyret përkatëse sipas nevojës;
- Ofrimi i informatave për mënyrën e realizimit të pagesave dhe të pikave të shitjes së biletave fizike;
- Pranimi i ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve dhe dorëzimi i tyre për protokolim pranë zyrtarëve përgjegjës.

**Kualifikimi dhe përgatitja profesionale**

- Shkollim universitar;
- Kurse dhe trajnime tjera gjatë karrierës profesionale;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe negocimi;
- Të ketë njohuri të mira të gjuhëve të huaja në të shkruar dhe të folur;
- Shkathtësi kompjuterike (Microsoft Office).

**Procedura e Konkurrimit**

Kandidati/ja për këtë pozitë, duhet të dorëzojë dokumentet si në vijim:

- Aplikacionin;
- Dëshminë e shkollimit (kopje të noterizuar);
- Çertifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj);
- Vërtetimin tatimor;
- CV-në;
- Letër motivuese;
- Ekstraktin e lindjes;
- Kopjen e letërnjoftimit.

**Kontratë pune: gjashtë (6) muaj punë provuese, me mundësi vazhdimi me kontratë për periudhë të pacaktuar në rast të vlerësimit pozitiv të performancës në punë.**

**II. Zyrtar/e për Shërbime ndaj Klientëve, një (1);**

**Departamenti i Operimeve, Divizioni i Shërbimit ndaj Klientëve, nr. ref.: 05**

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Komunikimi i efektshëm me klientët, që duhet të jetë në gjendje të ofrojë ndihmë dhe kujdes duke i dëgjuar ata dhe duke ofruar zgjidhje për problemet që ata kanë;
- Përgjigjje efektive ndaj pyetjeve të ndryshme dhe ankesave të klientëve
- Informimi i klientëve për shërbimet të cilat kryen N.P.L "Prishtina Parking";
- Ndërtimi i marrëdhënieve me klientët si; lidhja e kontratës së hapësirës shfrytëzuese të parkimit duke i'u ofruar shërbimet cilësore të gjithë klientëve;
- Takime me klientët e zonës së parë dhe zonës së dytë, të cilët kanë shprehur interesim të aplikojnë si banorë rezident;
- Informimi i klientëve për mënyrën e aplikimit si dhe plotësimin e të gjitha dokumenteve të nevojshme;
- Kontrollimi i dosjeve dhe mbajtja e evidencës se klientëve;
- Pritja dhe udhëzimi i klinetëve;
- Pritja e telefonatave dhe transferimi i thirrjeve tek personat përkatës;
- Regjistrimi ditor i vizitorëve dhe palëve;
- Regjistron transaksionet e pagesave nga ana e klientëve;
- Identifikimi dhe verifikimi i klientëve përmes dokumenteve të tyre personale apo përmes mjeteve tjera përgjatë ekzekutimit të pagesës;
- Arkivimi dhe mbajtja e dokumentacionit origjinal që ka të bëjë me marrëveshjen e Ndërmarrjes dhe klientit;
- Mirëmbajtja e klientëve ekzistues;
- Pergatit raporte periodike sipas nevojës;
- Raporton në mënyrë direkte tek Udhëheqësi i Divizionit.

**Kualifikimi dhe përgatitja profesionale**

- Shkollim universitar;
- Preferohet të ketë përvojë pune;
- Kurse dhe trajnime tjera gjatë karrierës profesionale;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe negocimi;
- Të ketë njohuri të mira të gjuhëve të huaja në të shkruar dhe të folur;
- Shkathtësi kompjuterike (Microsoft Office).

**Procedura e Konkurrimit**

Kandidati/ja për këtë pozitë, duhet të dorëzojë dokumentet si në vijim:

- Aplikacionin;
- Dëshminë e shkollimit (kopje të noterizuar);
- Dëshminë e përvojës së punës (Trusti pensional),
- Vërtetimin tatimor;
- Çertifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj),
- CV-në;
- Letër motivuese;
- Ekstraktin e lindjes;
- Kopjen e letërnjoftimit.

**Kontratë pune: gjashtë (6) muaj punë provuese, me mundësi vazhdimi me kontratë për periudhë të pacaktuar në rast të vlerësimit pozitiv të performancës në punë.**

**MËNYRA E APLIKIMIT:**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, që kanë përfunduar shkollimin adekuat dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave përkatëse. Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në adresën e Ndërmarrjes Publike Lokale "Prishtina Parking" SH.A., **rr. "Luan Haradinaj", p.n., Pallati i Rinisë (ish ASK), 10000, Prishtinë, Kosovë.**

Aplikacioni merret në selinë e N.P.L. "Prishtina Parking" SH.A. apo mund të shkarkohet në faqen zyrtare **www.prishtinaparking.net.** Kandidatët të cilët aplikojnë, duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues dhe e-mail adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

**Konkursi është i hapur në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data 08.04.2024 deri më 22.04.2024, deri në ora 16:00.**

---

**Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "E.D BERISHA" SHPK, Malishevë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:**

## DEBAT PUBLIK

**Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shfrytëzimin e gurit gëlqeror si gurë dekorativ në Zatriq, komuna e Rahovecit.**

**Njoftohet publiku i interesuar se më datën 29.05.2024 në ora 11:00 në në SHFMU "Dëshmorët e Zatriqit" Fshati Zatriq, Komuna Rahovec, do të organizohet debat publik nga Kompania "E.D BERISHA" SHPK, Malishevë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën për shfrytëzimin e gurit gëlqeror si gurë dekorativ në Zatriq, komuna e Rahovecit.**

**Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM**

https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1

Meeting ID: 701 265 1943
Passcode: 123456

**Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "E.D BERISHA" SHPK, Malishevë, për shfrytëzimin e gurit gëlqeror si gurë dekorativ në Zatriq, komuna e Rahovecit.**

https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2

**Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin** vnm.komente@rks-gov.net

**Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.**

PRISHTINA

**Ndërmarrja Publike Lokale "Prishtina Parking" Sh. A. Prishtinë**

PRISHTINA PARKING

Na temelju odredaba članka 8. Zakona br. 03/L-212 o radu i članak 4. Administrativnog uputstva (MPMS) br. 07/2017 za regulisanje tenderskih postupaka u javnom sektoru, lokalno javno poduzeće "Prishtina Parking" SH.A. najavi ovo:

08-04-2024
02 249/1

## JAVNI NATJEČAJ

**Za radna mjesta:**

**I. Recepcionar, jedan (1)**
**Odjel za upravu, br. ref. 04**

**Dužnosti i odgovornosti:**

- Komuniciranje s korisnicima usluga tvrtke na jasan i točan način;
- Prihvaćanje poziva građana i po potrebi prosljeđivanje poziva nadležnim uredima;
- Pružanje informacija o načinu plaćanja i prodajnim mjestima za fizičke ulaznice;
- Zaprimanje pritužbi i zahtjeva kupaca i njihovo dostavljanje na protokol nadležnim službenicima.

**Osposobljenost i stručna sprema**

- Sveučilišno obrazovanje;
- Tečajevi i druga usavršavanja tijekom profesionalne karijere;
- Imati dobre komunikacijske i pregovaračke vještine;
- Dobro poznavanje stranih jezika u pisanom i govornom obliku;
- Poznavanje rada na računalu (Microsoft Office).

**Procedura natjecanja**
Kandidat za ovu poziciju dužan je dostaviti sljedeću dokumentaciju:

- Aplikacija;
- Dokaz o stručnoj spremi (ovjerena kopija);
- Potvrda koja nije pod istragom (ne starija od šest (6) mjeseci);
- Porezna potvrda;
- CV;
- Motivacijsko pismo;
- Ekstrakt rođenja;
- Presliku osobne iskaznice.

**Ugovor o radu: šest (6) mjeseci probnog rada, uz mogućnost nastavka ugovora na neodređeno vrijeme u slučaju pozitivne ocjene radnog učinka.**

**II. Službenik korisničke službe, jedan (1);**
**Operativni odjel, Sektor korisničke službe, br. ref.: 05**

**Dužnosti i odgovornosti:**

- Učinkovita komunikacija s kupcima, koji moraju biti sposobni ponuditi pomoć i brigu slušajući ih i nudeći rješenja za probleme koje imaju;
- Učinkovit odgovor na razne upite i pritužbe kupaca
- Informiranje kupaca o uslugama koje pruža N.P.L "Prishtina Parking";
- Izgradnja odnosa s kupcima kao što su; sklapanje ugovora o korištenju parkirališnog prostora, pružanje kvalitetne usluge svim korisnicima;
